



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr.159

11 dhjetor

2012

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Dekret nr. 7835 datë 27.11.2012	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 8563
Dekret nr. 7846 datë 3.12.2012	Për emërim gjyqtari..... 8563
Dekret nr. 7847 datë 3.12.2012	Për disa ndryshime në dekretin nr. 6201, datë 8.6.2009 të Presidentit të Republikës “Për caktimin e kompetencave tokësore të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe të qendrës së ushtrimit të veprimtarisë së secilës prej tyre”..... 8564
Udhëzim i MB nr. 353, datë 27.11.2012	Për mënyrën e evidentimit dhe të shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative, procedurat që ndiqen për masat administrative plotësuese, administrimi i gjobave dhe pasqyrat statistikore në fushën e qarkullimit rrugor..... 8564
Vendim i KLD nr. 299/1, datë 30.11.2012	Për procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve për gjyqtarë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë dhe të Apelit..... 8603
Vendim i ERE nr. 159, datë 21.11.2012	Mbi kërkesën e shoqërisë “CEZ shpërndarje” për rinovim të licencës “Për aktivitetin e furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike” me nr. 68, seria P08FPP, të miratuar me vendimet e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 25.1.2008 dhe nr. 58, datë 3.6.2008..... 8609
Vendim i ERE nr. 160, datë 26.11.2012	Mbi ankimin administrativ të KESH sh.a. dhe “CEZ shpërndarje” sh.a. në lidhje me vendimin nr. 134, datë 17.9.2012 “Për miratimin e marrëveshjes së furnizimit me energji elektrike midis shoqërisë KESH sh.a./FPSH dhe shoqërisë “CEZ shpërndarje” sh.a./FPP për periudhën 1.1.2012-31.12.2014..... 8610

Urdhër i KDS
nr. 4492, datë 5.11.2012

Për delegim të disa kompetencave shefit të Qendrës së
Doktrinës..... 8611

Kërkesë për shpalljen të zhdukur dhe të vdekur të shtetases,
Bukurie Dervishi..... 8612

DEKRET
Nr. 7835, datë 27.11.2012

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, të nenit 9 pika 7 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar,

DEKRETOJ:

Neni 1

I jepet shtetësia shqiptare me kërkesën e saj:
Valdete Rifat Daka (Osmani)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 7846, datë 3.12.2012

PËR EMËRIM GJYQTARI

Në mbështetje të neneve 93 dhe 136, pika 4 të Kushtetutës, si dhe të nenit 12 pika 1 të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë,

DEKRETOJ:

Neni 1

Z. Artan Lazaj emërohet gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani



DEKRET

Nr. 7847, datë 3.12.2012

PËR DISA NDRYSHIME NË DEKRETIN NR. 6201, DATË 8.6.2009 TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS “PËR CAKTIMIN E KOMPETENCAVE TOKËSORE TË GJYKATAVE TË RRETHEVE GJYQËSORE DHE TË QENDRËS SË USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË SECILËS PREJ TYRE”

Në mbështetje të nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 6 paragrafi 3 të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Ministrit të Drejtësisë,

DEKRETOJ:

Neni 1

Në dekretin nr. 6201, datë 8.6.2009 të Presidentit të Republikës “Për caktimin e kompetencave tokësore të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe të qendrës së ushtrimit të veprimtarisë së secilës prej tyre”, bëhen këto ndryshime:

Në nenin 1 në pikën 15, fjalët “Bashkia Leskovik” hiqen.

Neni 2 shfuqizohet.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi më 1 janar 2013.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

UDHËZIM

Nr. 353, datë 27.11.2012

PËR MËNYRËN E EVIDENTIMIT DHE SHQYRTIMIT TË KUNDËRVAJTJEVE ADMINISTRATIVE, PROCEDURAT QË NDIQEN PËR MASAT ADMINISTRATIVE PLOTËSUESE, ADMINISTRIMI I GJOBAVE DHE PASQYRAT STATISTIKORE NË FUSHËN E QARKULLIMIT RRUGOR

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 11, pikës 1/a; b, të nenit 12 dhe nenit 201 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, të ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neneve 2 dhe 4/c të ligjit nr. 9900, datë 10.4.2008 “Për rezervat materiale të shtetit”, si dhe pikës 2/b të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1128, datë 5.8.2008 “Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore”, me qëllim që të ketë unifikim në shqyrtimin dhe evidentimin e kundërvajtjeve në fushën e qarkullimit rrugor, mënyrën e administrimit të gjobave, si dhe procedurat që ndiqen për masat administrative plotësuese për kundërvajtjet në fushën e qarkullimit rrugor,

UDHËZOJ:

A. Evidentimi dhe shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative

1. Kanë atributet e agjentit verifikues, për marrjen e masave administrative me gjobë dhe masave administrative plotësuese për shkelje të normave të legjislacionit rrugor, punonjësit e shërbimit të policisë rrugore (efektive në Drejtorinë e Policisë Rrugore, Komisariatin Rajonal të Policisë Rrugore Tiranë, komisaritet e policisë së trafikut në qarqe, komisaritet e menaxhimit të trafikut interurban) dhe patrullave të përgjithshme të policisë.

2. Për konstatimin e shkeljeve përpilohet procesverbali përkatës, sipas modelit të përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000 “Rregullore për zbatimin e Kodit Rrugor”, i ndryshuar (lidhja 1). Patrulla e përgjithshme e policisë merr masa administrative plotësuese vetëm për rastet e përcaktuara, në zbatim të nenit 155 dhe 156 të Kodit Rrugor (“Ndalim qëndrimi dhe pushimi i mjeteve”, “Ndalimi i qëndrimit dhe pushimit të mjeteve”).

Punonjësit e shërbimit të Patrullës së Përgjithshme, në të gjitha rastet e shkeljeve të parashikuara në nenin 157 të Kodit Rrugor, që kanë të bëjnë me heqjen dhe bllokimin e mjeteve, njoftojnë shërbimet e Policisë Rrugore për ushtrimin e kompetencave në bazë të Kodit Rrugor.

3. Procesverbali i konstatimit të shkeljes plotësohet në 4 (katër) kopje.

Punonjësi i policisë, në përfundim të shërbimit, i raporton dhe i dorëzon eprorit të drejtpërdrejtë ose atij të caktuar në këtë detyrë, origjinalin dhe kopjen e tretë të procesverbalit të konstatimit të shkeljes për verifikim dhe evidentim të mëtejshëm. Kopja e dytë i dorëzohet kundërvajtësit, ndërsa kopja e katërt mbetet në bllokun që zotëron agjenti verifikues.

4. Për kundërvajtjet e parashikuara nga nenet përkatëse të Kodit Rrugor, me vlerë deri në 5 000 (pesëmijë) lekë, agjenti verifikues merr masën e vendosjes së gjobës në vend. Në këto raste, agjenti verifikues i dorëzon kundërvajtësit një kopje të procesverbalit të konstatimit të shkeljes me masën e gjobës dhe e adreson atë për të kryer pagesën në arkat e operatorëve financiarë të kontraktuar, brenda afatit 5-(pesë) ditor, duke i prezantuar dhe favoret në zbatim të pikës 2 të nenit 203 “Kodi Rrugor”, të ndryshuar.

Përfundim nga kufiri sa sipër i vlerës së gjobës në vend, bëhet vetëm në rastet e aplikimit të masës administrative me gjobë, sipas nenit 205 të Kodit Rrugor.

5. Në të gjitha rastet e tjera, kur shkelja e konstatuar nga agjenti verifikues është kompetencë e shqyrtimit nga Organi Administrativ Shtetëror, sipas nenit 201 të Kodit Rrugor, agjenti verifikues plotëson procesverbalin e konstatimit, por në rubrikën ku shënohet vlera e gjobës në lekë, nuk e plotëson atë (vlerën e gjobës), pasi shqyrtimi i kësaj kundërvajtje bëhet nga Organi Administrativ Shtetëror. Në procesverbal shënohet afati kohor dhe vendi i paraqitjes së kundërvajtësit për të dhënë informacionin e duhur apo për paraqitjen e dokumenteve që vërtetojnë shkeljen e konstatuar. I njëjti shënim bëhet dhe në rastet e gjobës në vend, kur ajo shoqërohet me masë administrative plotësuese pa gjobë.

6. Për rastet e konstatimit të shkeljeve të rregullave të qarkullimit rrugor nga shërbimet e tjera të Policisë së Shtetit, që nuk kanë atributet e agjentit verifikues, njoftojnë shërbimin e Policisë Rrugore për kryerjen e procedurave ligjore.

7. Eprori i drejtpërdrejtë i agjentit verifikues ose ai i caktuar në këtë detyrë, bën kontrollin e saktësisë së plotësimit të procesverbalit dhe është autoriteti i vetëm përgjegjës për dorëzimin e dokumentuar të procesverbaleve të konstatimit të shkeljeve, në regjistrin përkatës (lidhja 3/a) në sektorin e statistikës të Komisarariatit.

Dorëzimi, si më sipër, nga eprori i drejtpërdrejtë ose ai i caktuar në këtë detyrë i procesverbaleve të konstatimit të shkeljeve, duhet të bëhet sa më shpejt, por në asnjë rast, jo më vonë se 16 orë nga koha e pranimit për kontroll.

8. Eprori i drejtpërdrejtë i agjentit verifikues ose ai i caktuar në këtë detyrë, kur konstaton se procesverbali i konstatimit të shkeljes është/janë të pabazuar në ligj apo me mangësi në plotësim



etj., përpilon argumentim ligjor të motivuar, sipas modularit bashkëlidhur (lidhja 2), pa lënë shenjë mbi procesverbalin/et e konstatimit të plotësuar nga agjenti verifikues, duke vepruar si më poshtë:

a) Në rastet kur procesverbali i konstatimit të shkeljes, është vetëm masë me gjobë në vend, propozimi për përmirësimin e gjendjes është vetëm masë disiplinore për agjentin verifikues, sipas procedurave të përcaktuara në Rregulloren e Disiplinës të Policisë së Shtetit.

b) Në rastet kur procesverbali i konstatimit të shkeljes, përveç masës me gjobë në vend, shoqërohet edhe me masë administrative plotësuese pa gjobë (për mjetin apo drejtuesin e mjetit), propozimi për përmirësimin e gjendjes është kërkesa e eprorit të drejtpërdrejtë të agjentit verifikues ose ai i caktuar në këtë detyrë, për dërgimin për gjykim të procesverbalit të konstatimit të shkeljes në Organin Administrativ Shtetëror.

Në këtë rast, miratimi i propozimit të eprorit të drejtpërdrejtë të agjentit verifikues nga titullari i strukturës, i kalon zyrtarisht Organit Administrativ Shtetëror, i cili merr detyrimet si në rastet e gjykimit të ankesave me shkrim.

Organi Administrativ Shtetëror, përveç vendimit për gjykimin e procesverbalit të konstatimit të shkeljes, të shprehë propozimin për përmirësimin e gjendjes.

c) Organi Administrativ Shtetëror ndjek të njëjtën procedurë edhe në rastet e konstatimit të parregullsive në procesverbalet e konstatimit të shkeljes, që janë kompetencë direkt e shqyrtimit nga ky Organ.

d) Propozimet e mësipërme të Organit Administrativ Shtetëror janë dokumenti argumentues ligjor me të cilin ndiqen procedurat e analizës së problemeve në plotësimin e procesverbaleve të konstatimit të shkeljes.

Plotësimi me mangësi i procesverbalit të konstatimit të shkeljes ose dhe mos dorëzimi sipas afateve të përcaktuara, konsiderohet shkelje e rëndë disiplinore.

9. Dokumenti argumentues ligjor, i plotësuar si më sipër, i paraqitet shefit të Komisarariatit të Policisë, i cili e vlerëson dokumentin e përpiluar nga eprori i drejtpërdrejtë i agjentit verifikues apo Organi Administrativ Shtetëror dhe propozimin e tij, zhvillon analizën e duhur të rastit, përcakton masat që duhen marrë dhe adreson regjistrimin e tij në regjistrin përkatës, sipas modelit bashkëlidhur (lidhja 3), si dhe në regjistrin e procesverbaleve (lidhja 3/a), që mbahen në sektorin e statistikës të Komisarariatit.

Dokumentin argumentues është pjesë përbërëse dhe ka të njëjtin afat ruajtjeje me atë të procesverbalit të konstatimit të shkeljes.

10. Organi Administrativ Shtetëror, i cituar në nenin 201 të Kodit Rrugor, në kuptimin e këtij udhëzimi, për shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative të konstatuara në fushën e qarkullimit rrugor nga agjentët verifikues, funksionon sipas kompetencës territoriale mbi bazë qarku.

Organi Administrativ Shtetëror përbëhet nga 3 (tre) oficerë policie të nivelit të parë drejtues, të cilët emërohen dhe shkarkohen nga ky funksion me propozim të drejtorit të Policisë Rrugore nëpërmjet zëvendës drejtorit të përgjithshëm për departamentin e sigurisë publike dhe me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Oficerët e Policisë që përzgjidhen për emërim në këto funksione janë me arsimin e lartë juridik apo ish-Akademine e Rendit, Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, dega "Transport" ose janë me përvojë pune në shërbimet e policisë rrugore jo më pak se 5 vjet.

11. Sanksionet administrative që jep Organi Administrativ Shtetëror janë:

I. Gjobë me vlerë deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë (ose sipas indeksimeve të bëra nga Ministria e Financave në vlerë minimale dhe maksimale sipas pikës 3 të nenit 193 të Kodit Rrugor).

II. Masa administrative plotësuese, të cilat ndahen në:

a) Pezullim i lejeqarkullimit në kufijtë kohorë, të përcaktuar nga nenet përkatëse të legjislacionit rrugor;

b) Pezullim i lejedrejtimit në kufijtë kohorë, të përcaktuar nga nenet përkatëse të legjislacionit rrugor;

c) Heqje e lejedrejtimit;

d) Kalimin e mjetit në strukturat e Rezervave Materiale të Shtetit për konfiskim, tjetërsim, shitje apo shkatërrim të mjetit rrugor, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

12. Ndaj vendimeve të Organit Administrativ Shtetëror, kur nuk është bërë ankim në gjykatë, sipas nenit 202 të Kodit Rrugor, mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve nga shpallja e vendimit, në organin administrativ më të lartë për shqyrtimin e ankimeve, në Drejtorinë e Policisë Rrugore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Organi administrativ më i lartë, kur konstaton shkelje të procedurave ose mospërputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, në zbatim të Kodit të Procedurave Administrative, shprehet përfundimisht me vendim, si dhe i propozon drejtorit të Policisë Rrugore, masat për përmirësimin e gjendjes apo dhe ato disiplinore për personat përgjegjës, sipas procedurave përkatëse disiplinore.

Organi administrativ më i lartë përbëhet nga 3 anëtarë:

Kryetari dhe anëtarët, propozohen nga drejtori i Policisë Rrugore dhe miratohen nga zëvendës drejtori i përgjithshëm për sigurinë publike.

13. Për sanksionet administrative që jep Organi Administrativ Shtetëror merret vendimi përkatës në prezencën e kryetarit dhe 2 anëtarëve e me shumicë votash, sipas modularit bashkëlidhur (lidhja 4). Në rast se një nga anëtarët e Organit ka mendim të ndryshëm për vendimin, ai shprehet në modularin e vendimit, duke e nënshkruar atë. Vendimi përpilohet në 3 (tri) kopje, një kopje i jepet kundërvajtësit, një kopje ruhet në praktikën e Organit Administrativ Shtetëror dhe kopja e tretë dorëzohet zyrtarisht në financën e Drejtorisë së Policisë së Qarkut për kryerjen e veprimeve financiare dhe evidentim.

Në vendim, Organi Administrativ Shtetëror përcakton vlerën e gjobës për shkeljen/et e konstatuara nga agjenti verifikues, vlera e të cilave nuk mund të kalojë kufijtë e përcaktuar nga Kodi Rrugor për shkeljen/et që i atribuohet. Në caktimin e masës së kësaj vlere, Organi Administrativ Shtetëror, përveç sa parashikohet në nenet e Kodit Rrugor, bazohet dhe në kriteret e nenit 18 të ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative".

Në vendim bëhet shpjegimi i përmbledhur i provave e fakteve, saktësohet e drejta e ankimit dhe afati kohor.

14. Procesverbali i konstatimit të shkeljes dhe vendimet që merr Organi Administrativ Shtetëror, evidentohen në regjistra të veçantë, sipas modularit bashkëlidhur (lidhja 5), si dhe në regjistra elektronikë, atje ku është e mundur, në funksion të kompletimit me sistemet informatike të miratuara.

15. Organi Administrativ Shtetëror shqyrton dhe ankimet (me shkrim) ndaj masës administrative plotësuese të dhënë nga agjenti verifikues.

Masat administrative plotësuese për të cilat shprehet Organi Administrativ Shtetëror me vendim janë:

a) Masa në lidhje me detyrimet për kryerjen e një veprimtarie të caktuar për pezullimin dhe ndalimin e një veprimtarie të caktuar;

b) Masa në lidhje me automjetin (ndalim administrativ, sekuestrim, heqje, bllokim). Me bllokim mjete, në kuptimin e këtij udhëzimi, do të kemi parasysh vendosjen e pajisjeve të posaçme të bllokimit në rrota nga agjenti verifikues.

c) Masa në lidhje me tërheqjen e dokumenteve të qarkullimit, të lejedrejtimit dhe targës/ve.

16. Organi Administrativ Shtetëror për ankimet e administruara, merr vendim sipas formularit, modeli (lidhja 6), vendim, i cili plotësohet në tri kopje. Një kopje e vendimit i jepet shtetasit, kopja e dytë ruhet në praktikën e Organit Administrativ dhe kopja e tretë i dërgohet zyrtarisht komisariatit ku është efektiv agjenti verifikues që ka kryer veprimet, të cilat janë ankimuar ose veprimet për masat plotësuese ndaj mjetit, për vazhdimin e procedurave të mëtejshme të shprehura qartë në vendim. Këto vendime, që lidhen vetëm me ankimet, evidentohen në regjistrin, sipas modularit bashkëlidhur (lidhja 7).



Në vendim bëhet shpjegimi i përmbledhur i provave e fakteve; saktësohen detyrimet dhe të drejtat e ankuesit me afatet përkatëse, si dhe procedurat që do të ndiqen deri në përfundim të procesit (kthim mjeti, heqje sekuestro, konfiskim, kalim në Rezervat Materiale të Shtetit për shitje ankand apo shkatërrim).

17. Aktiviteti i Organit Administrativ Shtetëror, si dhe organit administrativ më të lartë për shqyrtimin e ankimeve, në çdo rast pasqyrohet në protokoll të veçantë, ku pasqyrohen deklaratimet e shtetasit, të anëtarëve të organit administrativ, si dhe vendimet e marra.

18. Organi Administrativ Shtetëror për shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative mbledhet çdo ditë pune kur ka praktika për shqyrtim, pavarësisht numrit të tyre.

19. Lejedrejtimit e lëshuara nga një shtet i huaj, shqyrtohen nga Institucioni i Prefektit, në juridiksionin e të cilit është konstatuar shkelja. Procesverbali i konstatimit të shkeljes përkatëse, së bashku me dokumentet shoqëruese për shkeljen dhe lejen e drejtimit të mjetit, jo më vonë se 48 orë nga konstatimi i shkeljes, nga Komisariati i Policisë ku është efektiv agjenti verifikues, i përcillen zyrtarisht Institucionit të Prefektit, pa iu nënshtruar procedurave të Organit Administrativ Shtetëror për shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative.

Institucioni i Prefektit shqyrton vetëm sanksionin plotësues të procesverbaleve të konstatimit të shkeljeve dhe shprehet me vendim brenda 5 ditëve nga dita e administrimit të procesverbalit të konstatimit të shkeljes. Vendimi, së bashku me lejedrejtimin, i dërgohen zyrtarisht brenda 2 ditësh nga dita e marrjes së vendimit, Komisarit të Policisë që ka konstatuar shkeljen, i cili përgjigjet për administrimin e dokumentacionit dhe dërgimin e tyre brenda 5 ditëve në Drejtorinë Konsullore të Ministrisë së Jashtme.

20. Në të gjitha rastet, shqyrtimi i kundërvajtjeve në fushën e qarkullimit rrugor dhe ekzekutimi i tyre bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, duke përjashtuar ndryshimet dhe shmangiet e parashikuara nga Kodi Rrugor, i ndryshuar.

21. Regjistrat e përcaktuar sipas këtij udhëzimi ruhen me afat pesëvjeçar nga koha e mbylljes. Kur përdoren sistemet informatike të miratuara, bëhet kopje e regjistrave elektronikë, të cilët ruhen 5 (pesë) vjet.

22. Për kundërvajtjet që dënohen me masa plotësuese, si: tërheqja e dokumenteve të qarkullimit të automjetit, të lejedrejtimit, të targës, të pezullimit të lejeqarkullimit e lejedrejtimit apo heqjes së lejedrejtimit, OASH-ja brenda 2 (dy) ditëve pune nga data që vendimi ka marrë formë të prerë, njoftohet zyrtarisht Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor ku banon kundërvajtësi. E njëjta procedurë ndiqet për lejet e transportit, licencat etj., me organet që i kanë lëshuar ato.

Lejet e drejtimit të pezulluara evidentohen në regjistrin përkatës (lidhja nr. 13); ruhen në arkivin e OASH-së dhe dorëzohen të dokumentuara me përfundimin e afatit të pezullimit apo me heqjen e masës për pezullim nga një organ kompetent epror.

23. Emërimi dhe lëvizja e punonjësve të policisë për në ose nga Komisariati Rajonal i Policisë Rrugore Tiranë dhe Komisaritet e Policisë së Trafikut, janë respektivisht, për gradën deri në nënkomisar me urdhër të drejtorit të Policisë së Qarkut pas miratimit paraprak e të dokumentuar nga drejtori i Policisë Rrugore, dhe për gradat komisar e lart, me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, pas propozimit të përbashkët nga drejtori i Policisë së Qarkut dhe drejtorit të Policisë Rrugore.

B. Procedurat që ndiqen për masat administrative plotësuese

1. Automjetet dhe motomjetet për të cilat është marrë masë administrative plotësuese, si ndalim administrativ ose heqje mjeti, ruhen pranë pikave përkatëse të caktuara për këtë qëllim.

2. Ndalimi administrativ i automjeteve dhe motomjeteve bëhet në kufijtë kohorë, të përcaktuar në nenet përkatëse të Kodit Rrugor. Në rastet kur nuk është përcaktuar periudha kohore e ndalimit administrativ, ndalimi bëhet në varësi të mundësisë së kundërvajtësit për të paraqitur

dokumentacionin e munguar në momentin e konstatimit, por jo më shumë se pesë ditë kalendarike, kohë e nevojshme për paraqitjen e dokumentacionit të munguar ose për ankim në Organin Administrativ.

3. Në rast të mos paraqitjes së dokumentacionit të detyrueshëm ligjor të mjetit brenda këtij afati, ndaj kundërvajtësit, agjenti verifikues plotëson procesverbalin sipas kërkesës së pikës 8 të nenit 178 të Kodit Rrugor, për të cilin Organi Administrativ shprehet menjëherë me vendim për procedurat e mëtejshme.

4. Në rastet e identifikimit të drejtuesve të automjeteve debitorë për kundërvajtjet administrative në fushën e qarkullimit rrugor, për përmbushjen e detyrimeve financiare, agjenti verifikues plotëson procesverbalin e konstatimit të shkeljes (neni 203 i Kodit Rrugor) pa vlerë gjobe, por me masën plotësuese të ndalimit administrativ dhe dërgon mjetin në pikën e caktuar të ruajtjes.

5. Në të gjitha rastet kur Kodi Rrugor parashikon, përveç sanksionit me gjobë, edhe masa administrative plotësuese, kompetenca e vendosjes së masës administrative plotësuese është e agjentit verifikues që ka verifikuar shkeljen, duke respektuar dhe vartësinë territoriale.

6. Për ndalimin administrativ të automjeteve, agjenti që verifikon shkeljen, ndërpret qarkullimin e mjetit dhe e depoziton atë në vendin e caktuar të ruajtjes, sipas mënyrave të parashikuara në këtë udhëzim.

7. Për masat administrative plotësuese të bllokimit apo të heqjes së mjetit, bëhet shënimi përkatës në procesverbalin e konstatimit të shkeljes, i cili plotësohet në vendin e konstatimit të shkeljes. Procesverbali i konstatimit të shkeljes hartohet në katër kopje, sipas mënyrave të treguara më sipër dhe procedurave standarde të miratuara.

8. Për rastet kur Kodi Rrugor parashikon masën administrative parandaluese të sekuestrimit dhe masën plotësuese të konfiskimit administrativ, pas plotësimit të procesverbalit të konstatimit të shkeljes, mjeti dërgohet në ruajtje pranë Rezervave Materiale të Shtetit.

Kur kanë kaluar 5 ditë nga mospranimi i ankesës nga Organi Administrativ Shtetëror ose nga skadimi i afatit për ankesë tek Organi Administrativ Shtetëror, kur kjo nuk është paraqitur, ose nga skadimi i periudhës së caktuar të sekuestrimit, kur nuk është paraqitur kërkesa për heqjen e sekuestrimit; Organi Administrativ Shtetëror shprehet me vendim që mjeti me dosjen përkatëse i kalon strukturave të Rezervave Materiale të Shtetit, për veprime të mëtejshme sipas mënyrave të parashikuara në aktet ligjore. Përfundim nga kjo procedurë bëjnë rastet kur mjeti u takon personave që nuk kanë lidhje me shkeljen administrative, por në raste të tilla veprohet duke ndërprerë qarkullimin e mjetit dhe shoqërimin e tij së bashku me drejtuesin e mjetit në Komisaratin e Policisë për vazhdimin e procedurave të mëtejshme për verifikim e identifikim.

9. Dorëzimi i mjetit në pikën e ruajtjes bëhet me procesverbal dorëzimi mjeti sipas modelit që i bashkëngjitet udhëzimit (lidhja 8). Ai përpilohet në katër kopje nga të cilat: një kopje i dorëzohet kundërvajtësit, kopja e dytë qëndron në pikën e ruajtjes, kopja e tretë administrohet në Komisaratin e Policisë ku është efektiv agjenti verifikues, për t'u administruar në fashikullin e mjetit të ndaluar administrativisht dhe kopja e katërt administrohet nga agjenti verifikues për ndjekjen e procedurave të mëtejshme në lidhje me mjetin.

10. Mjeti shoqërohet në pikën më të afërt të caktuar të ruajtjes nga agjenti verifikues që ka konstatuar shkeljen dhe ka hartuar procesverbalin përkatës të konstatimit të shkeljes. Në pamundësi të shoqërimit të mjetit, kur situata emergjente e trafikut nuk e lejon shoqërimin e tij nga agjenti verifikues, ngarkohet një patrullë tjetër e shërbimit të Policisë Rrugore. Në të gjitha rastet, me sistemin e radiondërlidhjes në dispozicion, agjenti verifikues duhet të komunikojë me sallën e drejtimit dhe koordinimit për ndërhyrjen e realizuar dhe për mënyrën e veprimit deri në kryerjen e plotë të procedurave për zbatimin e masës administrative plotësuese. Informacioni administrohet në regjistrin përkatës të sallës së drejtimit dhe koordinimit.



11. Në procesverbalin e dorëzimit të mjetit në pikën e caktuar të ruajtjes, shkruhen të dhënat e plota të identifikimit të mjetit (marka, tipi, lloji, ngjyra, lloji i karburantit, targa, numri i shasisë sipas dokumentacionit dhe e krahasuar me numrin e shasisë në mjet, çelësat e mjetit, kilometrazhi sipas tregimit të tij në çastin e dorëzimit në pikën e ruajtjes).

12. Kur agjenti verifikues merr masë administrative plotësuese që ka të bëjë me tërheqjen e dokumenteve të qarkullimit apo dëshmisë së aftësisë, duhet pranuar që mjeti të depozitohet e të ruhet në një vend të përcaktuar nga drejtuesi/përdoruesi i mjetit. Në këto raste, kur është e nevojshme agjenti verifikues jep leje të përkohshme për qarkullim të kufizuar, sipas modelit bashkëlidhur (lidhja 9). Leja e përkohshme plotësohet në dy kopje, njëra i jepet drejtuesit të mjetit dhe tjetra është pjesë e kopjes së procesverbalit të konstatimit që dorëzohet në zyrën përkatëse.

13. Në çdo rast, kur agjenti verifikues merr masë administrative plotësuese pa gjobë, që ka të bëjë me mjetin apo dokumentet e drejtuesit të mjetit, plotësohet raporti i shërbimit, sipas modelit bashkëlidhur (lidhja 10 ose 10/1), raport, i cili administrohet si pjesë e procesverbalit të konstatimit të shkeljes.

14. Nëse bëhet fjalë për ndonjë send apo material tjetër në mjet dhe përdoruesi i mjetit nuk e largon atë nga mjeti, ai dhe gjendja e tij shënohen hollësisht në procesverbal. Procesverbali nënshkruhet nga agjenti verifikues, kundërvajtësi, si dhe nga marrësi në ruajtje i mjetit, i cili përgjigjet për ruajtjen e mëtejshme të tij, por pa mbajtur përgjegjësi për pasojat që rrjedhin nga koha e qëndrimit në pikën e ruajtjes.

15. Në rastet kur drejtuesi ose pronari i mjetit nuk është i pranishëm në mjetin e tij dhe heqja e mjeteve apo largimi i tyre është i parashikuar në dispozitat e Kodit Rrugor dhe nga sistemi i sinjalizimit vertikal me shenjën përkatëse, kjo bëhet me transferimin ose me tërheqjen e mjetit me pajisje të përshtatshme, për të mos dëmtuar mjetin e konstatuar në kundërvajtje. Shpenzimet përkatëse të ndërhyrjes përfshihen në shpenzimet për kryerjen e heqjes ose bllokimit të mjetit.

Për çdo rast si më sipër, brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 199 të Kodit Rrugor dhe sipas mënyrave të përcaktuara në nenin 351 të rregullores për zbatimin e Kodit Rrugor ("Mënyra e njoftimit jo të menjëhershëm"), struktura përgjegjëse e Policisë Rrugore, që ka kryer procedurën e heqjes apo bllokimit të mjetit, duhet të njoftojë sipas mënyrave të treguara në ligj, pronarin dhe zotëruesin e mjetit për faktin e heqjes apo bllokimit të mjetit, vendin e ndodhjes, pagesat e mundshme sipas afateve ligjore dhe pasojat që vijnë nga mosrespektimi i kërkesave ligjore.

16. Në të gjitha rastet e konstatimit të shkeljeve të përcaktuara në nenet e Kodit Rrugor, ku parashikohet masa administrative parandaluese e sekuestrimit dhe masa plotësuese e konfiskimit administrativ, mjeti dërgohet në ruajtje pranë Rezervave Materiale të Shtetit. Hartimi i dokumentacionit përkatës do të plotësohet në vend edhe nga të paktën dy punonjës të Policisë (agjenti verifikues që konstaton shkeljen dhe një specialist i nivelit të parë drejtues, që ka atributet e oficerit të policisë gjyqësore). Në çdo rast për shkelje të tilla, drejtuesit të mjetit do t'i merren detyrimisht deklarime të hollësishme me shkrim për motivet e kryerjes së kundërvajtjes. Praktika administrative e lartpërmendur është pjesë e procesverbalit të konstatimit të shkeljes, që dorëzohet së bashku me të në komisariatit e policisë.

17. Heqja e masës administrative plotësuese në lidhje me automjetin (sekuestrimi, ndalimi administrativ, heqja dhe bllokimi) bëhet nga organi që e ka vendosur atë dhe konkretisht:

- Nga agjenti verifikues, në rastet kur paraqitja e dokumentacionit të munguar dhe faturave të kryerjes së të gjitha pagesave bëhet brenda afatit të përcaktuar në procesverbalin e konstatimit të shkeljes, por gjithsesi brenda afatit kohor prej 5 (pesë) ditësh nga hartimi i procesverbalit të konstatimit të shkeljes, të hartuar sipas kompetencave të nenit 200 të Kodit Rrugor dhe konfirmimit të mos paraqitjes së ankimit tek Organi Administrativ Shtetëror për trajtimin e masës administrative plotësuese, duke plotësuar formularin sipas modelit nr. 12.

- Nga Organi Administrativ Shtetëror, kur vendimi është vlerësuar i pabazuar nga shqyrtimi i ankesës së paraqitur nga kundërvajtësi apo nga shqyrtimi sipas nenit 201 të Kodit Rrugor të 8570

procesverbalit të konstatimit të shkeljes. Në vendimin për shqyrtimin e ankesës, OASH-ja përcakton detyrimet dhe veprimet që do të kryejë komisarati përkatës për heqjen e masës administrative plotësuese ndaj mjetit.

18. Për evidentimin e mjeteve në ruajtje, në komisaratin e policisë ku është efektiv agjenti verifikues dhe në pikën e ruajtjes mbahet një regjistër i veçantë sipas modelit që i bashkëngjitet udhëzimit (lidhja 11). Pjesa tjetër e dokumentacionit administrohet në fashikuj të veçantë për çdo mjet pranë komisarit të policisë që ka kryer kalimin e mjetit në pikën e ruajtjes.

19. Dokumentet e mjeteve në ruajtje në komisaratin e policisë, sistemohen në përputhje me numrin që ka marrë automjeti në regjistër. Ato duhet të jenë të plota, lehtësisht të lexueshme dhe të konsultuara me arkivat dhe bankën e të dhënave të Policisë së Shtetit, për sa i përket lejedrejtimit, lejeqarkullimit, policës së sigurimit të detyrueshëm për përgjegjësi ndaj të tretëve (TPL) dhe çdo dokument tjetër të kërkuar.

20. Regjistrat hapen çdo fillim viti dhe ruhen 10 (dhjetë) vjet pas mbylljes, ndërsa dokumentet e përpiluara për bllokimin e mjeteve ruhen sipas kërkesave ligjore të administrimit të dokumentacionit në sistemin e Policisë së Shtetit, por jo më pak se 5 (pesë) vjet pas përfundimit të ekzekutimit të vendimit.

21. Në rastet e kthimit të mjetit, sipas neneve përkatëse të Kodit Rrugor, hartohet procesverbali përkatës në dy kopje, i cili nënshkruhet nga roja dhe nga pronari i mjetit ose nga personi i autorizuar prej tij, ku deklарohet se mjeti nuk ka pësuar dëme gjatë qëndrimit në ruajtje. Një kopje e këtij procesverbali i jepet të interesuarit, ndërsa kopja e dytë i bashkëngjitet fashikullit të mjetit të bllokuar, ku janë dokumentuar të gjitha veprimet me mjetin dhe ekstraktet e origjinës të dokumenteve të paraqitura nga kundërvajtësi ose pronari dhe të verifikuara nga shërbimi i Policisë Rrugore.

22. Dosja e mjetit që do të kalojë në Rezervat Materiale të Shtetit, të përmbajë:

- a) Procesverbalin e konstatimit të shkeljes;
- b) Vendimin e Organit Administrativ për gjykimin e shkeljes (në rast se ka);
- c) Njoftimet e kundërvajtësit dhe solidarit (në rast se ka) për masat administrative në ngarkim të tij;
- d) Vendimin e Organit Administrativ Shtetëror për kalimin e mjetit dhe të dosjes në Rezervat Materiale të Shtetit;
- e) Detyrimet financiare që i detyrohet kundërvajtësi shërbimit të Policisë Rrugore, deri në ditën kur mjeti dorëzohet te Rezervat Materiale të Shtetit;
- f) Procesverbali i dorëzimit të mjetit në Rezervat Materiale të Shtetit ose dhe në pikën e ruajtjes;
- g) Dokumentet identifikuese të mjetit (në rast se ka);
- h) Ekstraktet e origjinës ose kopje të dokumenteve identifikuese të drejtuesit të mjetit ose solidarit (në rast se ka);
- i) Pamje fotografike elektronike (në CD).

23. Për vlerësimin dhe kategorizimin e mjeteve të dorëzuara nga Policia në Rezervat Materiale të Shtetit, drejtori i përgjithshëm i Rezervave Materiale të Shtetit ngre komisionin përkatës për përfundimin e procedurave të mëtejshme (shkatërrim, shitje ankand, tjetërsim etj.).

24. Mjetet e kategorizuara për qarkullim, të cilat i janë nënshtruar procedurave të shitjes me ankand publik për tri herë me radhë dhe procedurat e ankandit kanë dështuar, të trajtohen për skrap. Edhe për këto raste, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor për heqjen nga qarkullimi dhe çregjistrimin e tyre.

25. Mjetet në pikat e ruajtjes së strukturave të Policisë së Shtetit, të ndaluara në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga pika 1 e nenit 203 të Kodit Rrugor, me plotësimin e afatit 3(tre)-mujor të



qëndrimit në pikën e ruajtjes, kalojnë në ambientet e Drejtorisë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit në juridiksionin e strukturës së Policisë Rrugore. Mjeti shitet nga strukturat e Rezervave Materiale të Shtetit sipas mënyrave të parashikuara në aktet në fuqi. Çmimi i shitjes shërben për pagesën e gjobës, kur kjo nuk është bërë, si dhe të shpenzimeve të transportit e të ruajtjes së mjetit. Mbetja e mundshme i kthehet atij që i takon.

26. Për mjetet në pikat e ruajtjes ndaj të cilave është aplikuar masa administrative plotësuese e ndalimit administrativ, por kundërvajtësi nuk paraqitet brenda afatit të përcaktuar në procesverbalin e konstatimit të shkeljes dhe ka kaluar afati kohor prej 5 (pesë) ditësh nga hartimi i procesverbalit të konstatimit të shkeljes, agjenti verifikues plotëson procesverbalin sipas kërkesës së pikës 8 të nenit 178 të Kodit Rrugor, për të cilin Organi Administrativ shprehet menjëherë me vendim për vlerën e gjobës, duke plotësuar dhe formularin “Njoftim për detyrim paraqitje” (lidhja 14) bashkëlidhur, i cili është pjesë e vendimit.

Vendimi dhe njoftimi evidentohen në regjistrin e veçantë përkatës (lidhja 5 e udhëzimit), duke shënuar në kolonën 11 të masës plotësuese: “Njoftim për detyrim paraqitje” dhe dorëzohen menjëherë në sekretarinë e Drejtorisë së Policisë së Qarkut për ndjekjen e procedurës së njoftimit. Dorëzimi në sekretari pasqyrohet në kolonën “vërejtje” të regjistrit të lartpërmendur.

Konfirmimi për kryerjen e njoftimit administrohet zyrtarisht nga Organi Administrativ Shtetëror, i cili merr vendim për kalimin e mjetit me dosjen e plotë në rezervat materiale të shtetit, për kryerjen e procedurave të mëtejshme.

Për vendimin si më sipër, i bëhet njoftim edhe kundërvajtësit, sipas procedurave të njoftimit në mungesë.

C. Evidentimi në mungesë i kundërvajtjeve administrative në fushën e qarkullimit rrugor

I. Evidentimi në mungesë i kundërvajtjeve administrative në fushën e qarkullimit rrugor nga ana e shërbimeve të Policisë Rrugore të Policisë së Shtetit, bëhet në këto raste:

- a) pamundësia për të arritur një mjet, që lëviz me shpejtësi shumë të madhe;
- b) kalim i një kryqëzimi me semafor, kur është ndezur drita e kuqe;
- c) parakalim në kthesë;
- d) zbulimi i një shkeljeje nga një funksionar ose një agjent në bordin e një mjeti për transport publik;
- e) zbulimi i shkeljes me anë të mjeteve me pajisje të përshtatshme, që bëjnë të mundur përcaktimin e kundërvajtjes, më pas ose pasi mjeti objekt është larguar nga vendi i kontrollit;
- f) zbulimi i shkeljes në mungesë të shkelësit dhe të pronarit të mjetit.

1. Punonjësi i shërbimit të patrullës së përgjithshme me atributet e agjentit verifikues evidenton në mungesë kundërvajtjet administrative në fushën e qarkullimit rrugor vetëm në rastet e konstatimit të shkeljeve në mungesë të drejtuesit të mjetit, të parashikuara në nenin 155 dhe 156 të Kodit Rrugor, i ndryshuar.

2. Në rastet e konstatimit të shkeljeve të normave të qarkullimit në mungesë të drejtuesit të mjetit, punonjësi i policisë vepron si më poshtë:

a) Njofton menjëherë sallën e drejtimit, koordinimit e emergjencave sipas juridiksionit territorial, duke i raportuar këto të dhëna: tipin, targën e mjetit, vendndodhjen, shkeljen e konstatuar, duke specifikuar sinjalistikën rrugore ekzistuese, numrin e serisë së procesverbalit të konstatimit që do të plotësojë;

b) Plotëson procesverbalin e konstatimit dhe një kopje e vendos në xhamin e mjetit.

3. Punonjësi i shërbimit të sallës së drejtimit, koordinimit e emergjencave të juridiksionit territorial dhe punonjësi i shërbimit të sallës së drejtimit, koordinimit e emergjencave të Komisarariatit Rajonal të Policisë Rrugore Tiranë, në rastet kur marrin njoftim për konstatimet e shkeljeve të normave të qarkullimit rrugor në mungesë, vepron si më poshtë:

a) Plotëson menjëherë të dhënat e marra në regjistrin modelin 1 bashkëlidhur. Regjistri duhet të plotësohet në mënyrë kronologjike për çdo rast të raportuar. Mosplotësimi në kohë dhe

saktë i regjistrimit përbën shkelje të rëndë disiplinore dhe ndaj personave përgjegjës të fillojë ecuria disiplinore në bazë të Rregullores së Disiplinës së Policisë së Shtetit;

b) Të njoftojë eprorin e drejtpërdrejtë të punonjësit të policisë që njofton shkeljen e konstatuar.

4. Punonjësi i policisë në përfundim të shërbimit i raporton dhe i dorëzon eprorit të drejtpërdrejtë ose atij të caktuar në këtë detyrë, origjinalin dhe kopjen e tretë të procesverbalit të konstatimit të shkeljes në mungesë për verifikim dhe evidentim të mëtejshëm sipas procedurave të përcaktuara më lart në këtë udhëzim.

Në këto raste, eprori i drejtpërdrejtë ose ai i caktuar në këtë detyrë, bën përveç kontrollit të saktësisë së plotësimit të procesverbalit dhe evidentimit të bërë në sallën e drejtimit, koordinimit e emergjencave sipas pikës 2/a.

II. Njoftimi i kundërvajtjeve administrative në fushën e qarkullimit rrugor të konstatuara në mungesë.

1. Njoftimi i kundërvajtjeve administrative në fushën e qarkullimit rrugor të konstatuara në mungesë të bëhet si më poshtë:

a) Nëpërmjet punonjësve të Policisë së Shtetit;

b) Nëpërmjet shërbimit postar mbi bazën e aktmarrëveshjes së përbashkët ndërmjet Policisë së Shtetit dhe Postës Shqiptare;

c) Njoftimi konsiderohet i kryer me korrektësi kur konfirmohet se është bërë në adresën e dhënë për rezidencën ose vendbanimin e kundërvajtësit ose pronarit të mjetit;

d) Dërgimi i njoftimit zyrtar dhe saktësia e adresës për njoftimin, bëhet nga struktura përkatëse policore ku është efektiv punonjësi i policisë që ka plotësuar procesverbalin e konstatimit të shkeljes në mungesë, jo më vonë se 24 orë nga koha e plotësimit të procesverbalit. Kur llogaritja e këtij afati qëllon në një ditë kur administrata është e mbyllur apo funksionon me orare të reduktuara, afati shtyhet për ditën pasardhëse të punës;

e) Dokumenti i konfirmimit të njoftimit si më sipër, i administruar zyrtarisht nga struktura përkatëse policore, është pjesë përbërëse e procesverbalit të konstatimit të shkeljes në mungesë, për efekte të hedhjes në sistem dhe llogaritjes së afateve të shlyerjes së detyrimeve nga kundërvajtësi;

f) Për çdo rast, kur njoftimi nuk është kryer brenda afatit prej 30 ditësh kalendarike nga konstatimi i shkeljes e për pasojë pagesa e gjobës së vendosur, nuk mund të kërkohej për arkëtim, të bëhet analizë e veçantë për përgjegjësitë e masat përkatëse.

Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit me akt të veçantë përcakton procedurat që do të ndiqen në raste të tilla.

D. Mënyra e administrimit të gjobave

1. Arkëtimi i gjobave bëhet nga kundërvajtësit në arkat e operatorëve financiarë që veprojnë në Republikën e Shqipërisë, duke respektuar procedurat ligjore përkatëse për përfitimin e shërbimit të marrëveshjes midis palëve.

2. Formulari “Procesverbali i konstatimit të shkeljes” është dokument me vlerë i miratuar me akt normativ, me numër serie progresiv, në katër kopje, nga të cilat: kopja e parë (origjinalja) dorëzohet në strukturat e financës së institucionit përkatës, kopja e dytë i dorëzohet kundërvajtësit (personit që ka kryer shkeljen), kopja e tretë dorëzohet në seksionin e statistikës (strukturë operacionale në komisaritet e policisë) ku është efektiv agjenti verifikues, për analizë apo shqyrtim të mëtejshëm dhe kur është objekt i shqyrtimit të kundërvajtjes, kjo kopje shoqëron praktikën e përpiluar për këtë rast, ndërsa kopja e katërt ngelet në bllok dhe i dorëzohet administratorit të letrave me vlerë (magaziner, kujdestar, arkëtar sipas strukturës).

3. Procesverbalet e konstatimit të shkeljeve duhet të jenë të plotësuara me germa kapitale, pa shkurtime në përcaktimin e shkelësit, pronarit, emër e mbiemër të agjentit verifikues dhe në rubrikën “sanksione”, duhet të kenë të plotësuara të gjitha elementet e faturës për arkëtim të përbërë



nga: kodi i institucionit përfitues, kodi i degës së thesarit, kodi i llogarisë ekonomike dhe kodi i llogarisë ekonomike të kamatëvonesës.

4. Për gjobat e vendosura nga Organi Administrativ Shtetëror për shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative, klienti, përveç vendimit të këtij organi duhet të pajiset me kopje të vendimit të Komisionit dhe të faturës për arkëtim, të nënshkruara nga përfaqësuesi i institucionit dhe i paraqet në bankën e nivelit të dytë (apo ent financiar të kontraktuar) për kryerjen e veprimeve të arkëtimit.

5. Për kundërvajtjet, objekt i të cilave janë mjetet me targa të huaja, arkëtimi i gjobës të bëhet në vend (me dokument financiar “mandat arkëtimi”) nga punonjësi i Policisë Rrugore apo i Patrullës së Përgjithshme ose në pamundësi të kryerjes së pagesës, të bëhet tërheqja e dokumentacionit (lejedrejtimi, leje qarkullimi, siguracion) e konfirmuar me dokument zëvendësimi deri në momentin e shlyerjes së detyrimit, sipas modularit bashkëlidhur (lidhja 9).

6. Dokumenti “mandat arkëtimi” me të cilin punonjësit furnizohen nga institucioni, hartohen në tri kopje: kopja origjinale së bashku me kopjen origjinale të “Procesverbalit i konstatimit të shkeljes” dorëzohen në financë, kopja e dytë së bashku me kopjen e dytë të “Procesverbalit i konstatimit të shkeljes” i dorëzohen kundërvajtësit dhe kopja e tretë qëndron në bllok.

7. Arkëtimi i shumës së vjelë të kryhet në arkën e institucionit, jo më vonë se 24 orë nga koha e vendosjes së gjobës dhe plotësimit të “mandat arkëtimit”. Struktura e financës plotëson menjëherë “faturën për arkëtim” dhe brenda ditës e paraqet atë në bankat e nivelit të dytë.

8. Administrimi financiar i “Procesverbalit i konstatimit të shkeljes” (administrimi, maturimi, regjistrimi i arkëtimit, kontabilizimi dhe pasqyrimi në evidencat dokumentare dhe elektronike kur ato janë të miratuara) të bëhet në zyrën e financës të institucionit në të cilin agjenti verifikues është punonjës, sipas kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 20.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar.

9. Operatorët financiarë apo entet financiare të kontraktuara për shërbimin e pagesës së gjobës dhe të faturës për arkëtim (sipas vendimit të OASH-së) do të raportojnë brenda ditës së nesërme të arkëtimit, të dhënat sipas formatit të miratuar dhe të rënë dakord nga palët.

10. Komisariati i policisë organizon arkëtimin e gjobave të paarkëtuara pas konfirmimit nga zyrat (sallat) e drejtimit për kalimin e afatit ligjor për pagesë të vullnetshme mbi 1 muaj.

11. Strukturat e financës të bëjnë çdo ditë me operatorët financiarë të kontraktuar, por në asnjë rast të mos kalojë 2 ditë pune, konfirmimin e gjobave nëpërmjet aktrakordimit dhe të shoqëruara me “mandat arkëtimet” ose ekstrakt përmbledhës të tyre, të pranuar në marrëveshje dypalëshe. Në të gjitha rastet, veprimet të jenë të konfirmuara nga thesari.

12. Arkëtimi i gjobës në çdo rast do të bëhet në kodin e strukturës policore ku vepron agjenti verifikues që ka vendosur gjobën.

13. Për gjobat e vendosura dhe të paarkëtuara në afat (data e vendosjes së gjobës plus katër ditë të tjera), të aplikohet kamatëvonesa në masën 2% të vlerës së gjobës për çdo ditë deri në një muaj (30 ditë). Nëse arkëtimi i vlerës së gjobës bëhet brenda 5 pesë ditëve nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë, gjoba ulet me 20% të vlerës.

14. Dënimi administrativ që nuk ekzekutohet me kalimin e 2 (dy) viteve nga data e nxjerrjes së vendimit për kundërvajtjen administrative, parashkruhet (neni 46 i ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”). Në këtë rast, Organi Administrativ Shtetëror që ka nxjerrë vendimin për kundërvajtjen administrative, me vendim konstaton parashkrimin. Në vendimin e konstatimit të parashkrimit të dënimit administrativ, listohen dhe arsyet që kanë çuar në këtë përfundim, si dhe përgjegjësitë përkatëse sipas nenit 44 të ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

15. Gjobat e arkëtuara të derdhen në degën e thesarit të rrethit nga operatorë financiarë që kryejnë arkëtimin e gjobave me pjesëmarrje 40% buxheti dhe 60% organit që ka verifikuar shkeljen, sipas nenit 203 të Kodit Rrugor dhe nenit 41 të ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet

administrative”. Për këtë Drejtoria e Planifikimit Financiar dhe Drejtoria e Buxhetit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, të rialokojnë (rishpërndajnë) fondet e nevojshme të argumentuara dhe të miratuara nga drejtori i përgjithshëm i policisë, për kompletimin e strukturave të Drejtorisë së Policisë Rrugore me mjete e pajisje të nevojshme për rritjen e sigurisë në rrugë.

E. Hartimin e pasqyrave statistikore

1. Shërbimet e Policisë Rrugore plotësojnë këto pasqyra statistikore:

a) Pasqyra e aksidenteve rrugore sipas llojit të rrugës, vendit, kushteve e shkaqeve, model 1/AR nr. 7;

b) Pasqyra e aksidenteve rrugore sipas strukturave të Policisë Rrugore model 2/AR nr. 8;

c) Pasqyra e aksidenteve rrugore sipas ndarjes territoriale të strukturave rajonale e vendore të Policisë Rrugore model 2/AR nr. 8/1;

d) Pasqyra e masave administrative sipas kundërvajtjeve, model 1/MA nr. 9;

e) Pasqyra e masave administrative sipas strukturave rajonale e vendore të Policisë Rrugore, model 2/MA nr. 10.

2. Nga strukturat rajonale dhe vendore të Policisë Rrugore plotësohen çdo 1 (një) muaj dhe çdo 3 (tre) muaj pasqyrat e përcaktuara në pikën 1 germa “a”, “c”, “d”.

Të dhënat statistikore për plotësimin e pasqyrave model 1/MA nr. 9 dhe model 2/MA nr. 10, sigurohen nëpërmes sistemit E-gjoba, plotësohen prej specialistit të statistikës në seksion, firmosen prej tij dhe prej shefit të seksionit. Pasqyrat plotësohen në dy kopje, një kopje administrohet në sekretarinë e Komisarariatit, ndërsa kopja tjetër dërgohet në mënyrë elektronike brenda datës 2 (dy) dhe zyrtarisht brenda datës 5 të muajit pasardhës, në Drejtorinë e Policisë Rrugore në departamentin e sigurisë publike.

3. Pasqyra e aksidenteve rrugore sipas llojit të rrugës, vendit, kushteve e shkaqeve, model 1/AR nr. 7, plotësohet mbi bazën e informacionit të marrë prej formularit të “Raportit të aksidentit rrugor” (model IV. 8/a), i miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 297, datë 24.5.2006. Ky formular plotësohet në çdo rast nga oficeri i Policisë Rrugore që kryen veprimet e para në vendngjarje (që shkon i pari në vendngjarje, me atributet e policisë gjyqësore), i cili është përgjegjës për plotësimin e saktë dhe të plotë të të gjitha rubrikave (33 rubrika) që përmban raporti. Formulari kontrollohet e kundërfirmohet nga shefi i seksionit ku është efektiv oficeri i Policisë Rrugore që ka kryer veprimet e para në vendngjarje dhe dorëzohet brenda 24 orëve të ndihmës specialisti për AIS në Komisariatin Rajonal të Policisë Rrugore Tiranë ose te specialisti i statistikës në komisaritet e policisë së trafikut dhe komisaritet e menaxhimit të trafikut interurban, sipas përkatësisë territoriale të vendit të ngjarjes. Dorëzimi i formularit bëhet vetëm duke nënshkruar në regjistrin përkatës (Model AIS). Specialisti i statistikës/ndihmësspecialisti për AIS, menjëherë bën regjistrimin e aksidentit në “bazën e të dhënave” në programin e instaluar në kompjuterët lap-topë të shpërndarë për funksionimin normal të këtij programi.

Të dhënat e aksidenteve të marrë prej formularit të “Raportit të aksidentit rrugor” (model IV. 8/a), dërgohen *on line* çdo ditë në Drejtorinë e Policisë Rrugore.

Brenda datës 5 të muajit pasardhës, së bashku me pasqyrat e tjera sipas pikës 1.2, dërgohen zyrtarisht në Drejtorinë e Policisë Rrugore në Departamentin e Sigurisë Publike 1 (një) kopje e formularëve të “raportit të aksidentit rrugor”, ndërsa origjinali i çdo formulari administrohet në sekretarinë e komisarariatit.

4. Drejtoria e Policisë Rrugore (sektori i statistikës, përpunimit të dokumenteve dhe A.I.S) në Departamentin e Sigurisë Publike, pasi përpunon të gjitha pasqyrat dhe formularët e plotësuar nga strukturat e shërbimeve të Policisë Rrugore, bën përmbledhëset e tyre dhe dërgon brenda datës 10 të muajit pasardhës të 3(tre)-mujorit mujorit në sektorin e statistikës në Drejtorinë e Qendrës së Përpunimit dhe Mbrotjtjes së të Dhënave, përmbledhëset e treguesve statistikorë në shkallë vendi sipas pasqyrave, model 1/AR nr. 7, model 2/AR nr. 8 dhe model 2/MA nr. 10.



5. Modelet e pasqyrave statistikore, formularëve dhe regjistrave i bashkëlidhen udhëzimit dhe janë pjesë e pandashme e tij.

6. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe njësitë shpenzuese në përbërje të programit “Policia e Shtetit”, institucioni i Prefektit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit për zbatimin e këtij udhëzimi.

7. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme, në cilësinë e nëpunësit autorizues, ndjek zbatimin e këtij udhëzimi.

8. Shfuqizime:

- Udhëzimi i Ministrit të Brendshëm nr. 102, datë 13.6. 2012 “Për mënyrën e evidentimit në mungesë të kundërvajtjeve administrative në fushën e qarkullimit rrugor”.

- Udhëzimi i Ministrit të Brendshëm nr. 460, datë 22.12. 2010 “Për disa shtesa e ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 920, datë 11.7.2008 “Për hartimin e pasqyrave statistikore në Policinë e Shtetit””.

- Udhëzimi i Ministrit të Brendshëm nr. 388, datë 2.11.2010 “Për mënyrën e evidentimit dhe të shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative; procedurat që ndiqen për masat administrative plotësuese, si dhe për administrimin e gjobave në fushën e qarkullimit rrugor”, si dhe çdo akt normativ i nxjerrë nga kjo Ministri e që bie ndesh me këtë udhëzim.

Me këtë udhëzim të njihen të gjitha efektivat e Policisë së Shtetit, institucioni i Prefektit dhe punonjësit e Rezervave Materiale të Shtetit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Flamur Noka

REPUBLIKA E SHQIPERISE MINISTRIA E BRENDSHME INSTITUCIONI _____ ID PUNONJESIT _____		SERIA NR. _____ Nr.Regj. _____	
			
PROCES VERBAL I KONSTATIMIT TE SHKELJES			
DATA / VENDI	Data ____/____/201__		Ora ____
	Rruga _____ Vendi _____		
SHKELESI	Emer /mbiemer _____		Leje drejtimi /kateg. ____
	Nr _____ Adresa _____		
MIJETI	Tipi _____ Targa _____ kapaciteti _____		
	tipi I rimorkios _____ Targa _____ kapaciteti _____		
Pronari	Emer /mbiemer (ose subjekti) _____		
	Adresa _____		
SHKELJA	Ka shkelur ligjin Nr _____ Date ____/____/____ Neni _____		

DEKLARAT E	Deklaroj se _____		

SANKSIONI	Te gjobet me (_____) _____ Leke _____		
	Mase Plotesuese _____		
	Pagesa behet brenda 5 diteve kur merr forme te prere .Me kalimin e afatit paguhet 2% kammat ne dite Kodi i Llogarise Ekonomike te Kamatevoneses te jete 711 5500		
	Kodi i Institucionit _____ Kodi Deges Thesarit _____		
Kodi i Llogarise Ekonomike 711 5410			
SHKELESI _____		PUNONJESI I POLICISE _____	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDASHME
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
Komisariati Policisë _____

_____, më ____, ____, 20__

KONTROLI I PROCESVERBALIT
TË KONSTATIMIT TË SHKELJES

Sot, datë ____. ____. 20__, unë i nënshkruari _____,
me detyrë _____, pasi kontrollova procesverbalin
e konstatimit të shkeljes me numër serie _____, përpiluar nga punonjësi i
Policisë _____, në datën ____, ____, 20__, në vendin e quajtur
_____, ndaj shkelësit _____, që drejtonte mjetin me targë
_____, tip _____,
i llojit _____

Konstatova se:

Për sa më sipër, ky procesverbal i
konstatimit të shkeljes është plotësuar në mënyrë jokorrekte, prandaj për përmirësimin e gjendjes
proponoj _____.

Funksioni, grada, emër, mbiemër, firma.

Nr. ____ prot. datë ____, ____, 20__.

Për veprim:

Shefi i Komisariatit të Policisë.....

(grada, emër, mbiemër)

REGJISTRI I PROCESVERBALEVE TË KONTROLLUARA ME MANGËSI NË PLOTËSIMIN E TYRE (RPM)

Nr.	Data	Procesverbali i konstatimit të shkeljes			Përpiluar nga:	Kontrolluar nga:	Miratuar më:		Përfundimi dhe rregullimi
		Nr. i serisë	Data	Vlera			Nr.prot.	Data	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

Shënim.

1. Në kolonën e parë shënohet numri rendor në vijimësi i regjistrimit të procesverbalit të kontrolluar me të meta.
2. Në kolonën e dytë shënohet data e regjistrimit në këtë regjistër.
3. Në kolonën e tretë shënohet numri i serisë i procesverbalit të konstatimit që kontrollohet.
4. Në kolonën e katërt shënohet data e plotësimit të procesverbalit të konstatimit të shkeljes.
5. Në kolonën e pestë shënohet vlera e masës administrative me gjobë të vendosur në procesverbalin e konstatimit të shkeljes.
6. Në kolonën e gjashtë shënohet emri dhe mbiemri i punonjësit të Policisë që ka plotësuar, përpiluar procesverbalin e konstatimit të shkeljes.
7. Në kolonën e shtatë shënohet emri dhe mbiemri i eprorit të drejtpërdrejtë që ka kontrolluar procesverbalin e konstatimit të shkeljes.
8. Në kolonën e tetë shënohet numri i protokollit të miratimit të kontrollit të vendosur në modelarin e kontrollit të procesverbalit të konstatimit të shkeljes pas firmosjes nga shefi i njësisë rajonale të Policisë Rrugore.
9. Në kolonën e nëntë shënohet data e miratimit të kontrollit të procesverbalit të konstatimit të shkeljes nga shefi i njësisë rajonale të Policisë Rrugore.
10. Në kolonën e dhjetë shënohet me shkrim përfundimi në të cilin ka dalë eprori i drejtpërdrejtë, si dhe rregullimi i procesverbalit me të meta.



REGJISTRI I PROCESVERBALEVE DITORE TË DORËZUARA NGA AGJENTËT VERIFIKUES

Nr.	Data	Procesverbali i konstatimit të shkeljes					Dorëzuesi (eprori i drejtpërdrejtë)		Punonjësi/a pranues i statistikës		Operatori	
		Nr. i serisë	Data	Vlera	Masa plotësuese	Agjenti verifikues (emër, mbiemër)	Emër, mbiemër	Firma	Emër, mbiemër	Firma	Data	Emri, mbiemri
1	2	3	4	5	6		7	8	9	10	11	12



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
Drejtoria e Policisë së Qarkut
Organi Administrativ Shtetëror

_____, më ___, ___, 20__.

VENDIMI Nr. _____
(për shqyrtimin e kundërvajtjes)

Në datën ___, ___, 20__, Organi Administrativ, i përbërë nga kryetar: _____
dhe anëtarë _____ i mbledhur për
shqyrtimin e procesverbalit të konstatimit të shkeljes nr. _____, datë _____ të
përpiluar nga _____ në ngarkim të shtetasit
_____, që drejtonte automjetin me targë _____, marka _____,
tipi _____, lloji _____, në pronësi të _____
dhe konstatoi:

_____. Veprimet e mësipërme
bien në kundërshtim me ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998, neni ___, pika _____ germa _____.
Duke vlerësuar _____

_____.
Në mbështetje të nenit 201, nenit _____ të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, Organi Administrativ
vendosi që shtetasin _____:

1. Ta gjobisë me _____ (_____) lekë.
2. Të pezullojë (anulojë) lejen e _____ për _____ muaj.

Dënimi fillon nga _____ dhe mbaron më _____.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 5 (pesë) ditëve.

ORGANI ADMINISTRATIV

KRYETAR

ANËTAR

ANËTAR

REGJISTRI I VENDIMEVE TË ORGANIT ADMINISTRATIV SHETETËROR (RV)

Data	Numri i vendimit	Emri, mbiemri	Targa	Marka	Tipi	Lloji	Shkelja	Numri i lejedrejtimit	Vendimi		Afati		Vërejtje
									Gjoha e Komisionit	Masa plotësuese	Fillon	Mbaron	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14

Shënim.

1. Në kolonën e parë shënohet data e vendimit të Organit Administrativ (p.sh. 22.12.2014).
2. Në kolonën e dytë shënohet numri i vendimit të Organit Administrativ që është konsektiv (p.sh. 00012).
3. Në kolonën e tretë shënohet emri dhe mbiemri i kundërvajtësit (p.sh. Sokrat Shënediela).
4. Në kolonën e katërt shënohet targa e mjetit me të cilën është kryer kundërvajtja (p.sh. TR 1234 U).
5. Në kolonën e pestë shënohet marka e mjetit (p.sh. Mitsubishi).
6. Në kolonën e gjashtë shënohet tipi i mjetit me të cilin është kryer kundërvajtja (p.sh. Pajero).
7. Në kolonën e shtatë shënohet lloji i mjetit me të cilin është kryer kundërvajtja (p.sh. ATP).
8. Në kolonën e tetë shënohet shkelja e kryer (p.sh. 178/1).
9. Në kolonën e nëntë shënohet numri i lejedrejtimit të kundërvajtësit nëse ka (p.sh. 123456789).
10. Në kolonën e dhjetë shënohet vlera e gjobës së vendosur (p.sh. 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë).
11. Në kolonën e njëmbëdhjetë shënohet me shkrim masa administrative plotësuese e vendosur nga Organi Administrativ (p.sh. pezullim lejedrejtimi).
12. Në kolonën e dymbëdhjetë shënohet fillimi i afatit të masës administrative plotësuese.
13. Në kolonën e trembëdhjetë shënohet mbarimi i afatit të masës administrative plotësuese.
14. Në kolonën e katërmëdhjetë shënohet procedura e përcaktuar në vendim pas plotësimit të afatit kohor të masës plotësuese, si dhe ndonjë vërejtje e mundshme, e cila është në vlerësim të Organit Administrativ.

Lidhja 6



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
Drejtoria e Policisë së Qarkut
Organi Administrativ Shtetëror

_____, më _____, 20__

VENDIMI Nr. _____
(Për shqyrtim ankese)

Në datën____, _____, 20__ Organi Administrativ i përbërë nga kryetar:
_____ dhe anëtarë _____

_____ i mbledhur për shqyrtimin e
ankesës së shtetasit _____ për masën plotësuese të
_____ sipas procesverbalit të konstatimit të shkeljes
nr._____, datë____, _____, 20__ të përpiluar nga _____, në ngarkim të
shtetasit _____ që drejtonte automjetin me targë _____,
marka_____, tipi _____, lloji _____ në
pronësi të _____ konstatoi se:

_____ veprime
këto, që bien në kundërshtim me ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998, i ndryshuar, neni _____, pika
_____ germa _____.

Duke vlerësuar _____

_____.
Në mbështetje të nenit 201, nenit _____ të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, të ndryshuar, Organi
Administrativ vendosi që:

ORGANI ADMINISTRATIV

KRYETAR

ANËTAR

ANËTAR

REGJISTRI I SHQYRTIMIT TË ANKIMEVE NË ORGANIN ADMINISTRATIV SHTETËROR (RSA)

Data	Numri konsekutiv i ankimit	Data dhe numri i vendimit që kundërshtohet	Emri, mbiemri i ankuesit	Shkelja e konstatuar në procesverbal	Ankesa dhe çfarë shkelje pranon kundërvajtësi	Vendimi i Organit Administrativ pas ankimit	Afatit i vendosur nga Organi Administrativ		Vërejtje
							Fillon	Mbaron	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

Shënim.

1. Në kolonën e parë shënohet data e shqyrtimit të ankimit në komisionin administrativ (p.sh. 22.12.2014).
2. Në kolonën e dytë shënohet numri konsekutiv i regjistrimit të ankimit të komisionit administrativ (p.sh. 00012).
3. Në kolonën e tretë shënohet data dhe numri i vendimit të komisionit administrativ që kundërshtohet, nëse ka një vendim.
4. Në kolonën e katërt shënohet emri dhe mbiemri i ankimuesit (p.sh. Sokrat Shënediela).
5. Në kolonën e pestë shënohet shkelja për të cilën është ndëshkuar kundërvajtësi dhe të cilën mund ta ketë shqyrtuar Komisioni.
6. Në kolonën e gjashtë shënohet ankesa dhe çfarë pranon ankimuesi nga kundërvajtja e konstatuar nëse pranon shkeljen.
7. Në kolonën e shtatë shënohet vendimi i Komisionit pas shqyrtimit të ankimit.
8. Në kolonën e tetë shënohet fillimi i afatit të masës administrative plotësuese.
9. Në kolonën e nëntë shënohet mbarimi i afatit të masës administrative plotësuese.
10. Në kolonën e dhjetë shënohet procedura e përcaktuar në vendim pas plotësimit të afatit kohor të masës plotësuese, si dhe ndonjë vërejtje e mundshme, e cila është në vlerësim të Komisionit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
Komisariati i Policisë _____

_____, më ____, ____, 20__.

PROCESVERBAL Nr. _____
PËR DORËZIMIN E AUTOMJETIT NË PIKËN E RUAJTJES

Procesverbal i mbajtur sot në datën ____, ____, 20__, për dorëzimin e mjetit me targë _____, në pronësi të _____ të markës _____, tipi _____, lloji _____ dhe numër shasie _____, me kilometra të përshkuar (sipas tregimit të kilometrazhit) _____, pranë pikës së ruajtjes _____.

Automjeti dorëzohet si më poshtë: çelësa kuadri copë _____, të dymve copë _____, dokumente që bllokohen me mjetin _____. Përshkrimi i automjetit _____.

_____. Në mjet ndodhen _____ për të cilat përdoruesi mjetit u njoftua t'i largonte nga mjeti, pasi për pasojat që mund të ndodhin vetëm si rezultat i kohës së qëndrimit të mjetit në pikën e ruajtjes, nuk përgjigjet roja apo organi verifikues.

Mosparaqitja brenda 5 ditëve kalendarike (ose pas kalimit të tre muajve sipas nenit 203 të Kodit Rrugor) të dokumenteve për tërheqjen e mjetit, sjell konfiskimin e tij dhe kalimin në favor të shtetit.

Marrësi në dorëzim
(punonjësi i pikës ruajtjes)

(emri, mbiemri, firma)

Dorëzuesi
(punonjësi i Policisë Rrugore)

(emri, mbiemri, firma)

Pronari i automjetit (ose drejtuesi)

(emri, atësia, mbiemri, firma, adresa dhe numri i telefonit)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDASHME
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
Komisariat i Policisë _____

_____, më ____, ____, 20__

PROCESVERBAL

(leje e përkohshme për qarkullim të kufizuar)

Sot, më ____, ____, 20 ____, unë _____, në vendin e quajtur _____, pasi verifikova mjetin që mbante targat _____, deklaroj se i kam tërhequr drejtuesit të mjetit, zotit/zonjës _____ dokumentet:

- Lejen e drejtimit nr. _____ lëshuar në _____ me _____. ____.

- Lejen e qarkullimit nr. _____ lëshuar në _____ me _____. ____ për mjetin me targë _____ etj. _____

_____, për shkelje të nenit _____ të Kodit Rrugor.

Lejohet të udhëtojë nga _____ deri në _____ për datën _____. _____. 20 ____.

Agjenti verifikues

(_____)

RAPORT SHËRBIMI

Nr. _____

(Për masë administrative plotësuese ndaj mjetit)

Sot, më _____, _____, 20____, unë _____, në vendin e quajtur _____, verifikova mjetin që mbante targat _____ dhe pasi konstatova se _____. Sa më sipër për drejtuesin e mjetit _____, plotësova procesverbalin e konstatimit të shkeljes me numër serial _____ dhe datë _____, 20____, për shkeljen e nenit _____ të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, Kodi Rrugor, të ndryshuar, që parashikon masën administrative me gjobë dhe masën plotësuese _____.

Për këtë, me procesverbalin nr. _____, datë _____, 20____, u bë dorëzimi në pikën e ruajtjes _____ i mjetit me targa _____, që drejtohej nga shtetasi _____, me adresë _____.

Punonjësi i Policisë Rrugore

(_____)



RAPORT SHËRBIMI

Nr. _____

(Për masë administrative plotësuese ndaj drejtuesit të mjetit)

Sot, më _____, _____, 20 ____, unë _____, në vendin e quajtur _____, verifikova mjetin që mbante targat _____ dhe pasi konstatova se _____. Sa më sipër për drejtuesin/përdoruesin e mjetit _____ plotësova procesverbalin e konstatimit të shkeljes me numër serial _____ dhe datë _____, _____, 20 ____, për shkeljen e nenit _____ të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, Kodi Rrugor, të ndryshuar, që parashikon masën administrative me gjobë dhe masën plotësuese _____.

Për këtë, me procesverbalin (kopje bashkëlidhur) u lejua drejtuesi/përdoruesi i mjetit me targa _____, të udhëtojë nga _____ deri në _____ për datën _____ . 20 ____.

Punonjësi i Policisë Rrugore

(_____)

REGJISTRI I MJETEVE TË DORËZUARA NË PIKËN E RUAJTJES

Nr.	Data	Pronësia		Targa	Marka	Tipi	Lloji	Numri i shasisë	Shkelja	Masa plotësuese	Vendimi i Organit Administrativ	Heqja e masës		Shlyerja e detyrimeve	Vërejtje
		Emër mbiemër	Adresa									Data	Arsyeja		
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16

Shënim.

1. Në kolonën e parë shënohet numri rendor progresiv.
2. Në kolonën e dytë shënohet data e dorëzimit në pikën e ruajtjes (p.sh. 22.12.2014).
3. Në kolonën e tretë shënohet emri dhe mbiemri i pronarit (p.sh. Sokrat Shënediela).
4. Në kolonën e katërt shënohet adresa e plotë e pronarit të mjetit.
5. Në kolonën e pestë shënohet targa e mjetit që dorëzohet në pikën e ruajtjes (p.sh. TR 1234 U).
6. Në kolonën e gjashtë shënohet marka e mjetit (p.sh. Mitsubishi).
7. Në kolonën e shtatë shënohet tipi i mjetit (p.sh. Pajero).
8. Në kolonën e tetë shënohet lloji i mjetit (p.sh. ATP).
9. Në kolonën e nëntë shënohet numri i shasisë i plotë me të 17-të karakteret).
10. Në kolonën e dhjetë shënohet shkelja e konstatuar (p.sh. qarkullon pa leje drejtimi më vete).
11. Në kolonën e njëmbëdhjetë shënohet masa administrative plotësuese (p.sh. ndalim administrativ).
12. Në kolonën e dymbëdhjetë shënohet vendimi i Organit Administrativ (p.sh. nuk pranohet ankesa).
13. Në kolonën e trembëdhjetë shënohet data e heqjes së masës administrative plotësuese.
14. Në kolonën e katërbëdhjetë shënohet arsyeja e heqjes së masës administrative plotësuese (p.sh. paraqiti leje drejtimin nr. _____).
15. Në kolonën e pesëmbëdhjetë shënohen ekstremet e dokumenteve për shlyerjen e detyrimeve me nr. dhe vlerë.
16. Në kolonën e gjashtëmbëdhjetë bëhen shënime të ndryshme kur mjete del nga pika e ruajtjes (p.sh. me vendim nr. ___, datë ___ u dërgua në pikat e rezervës materiale sipas procesverbalit përkatës).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
Komisariat i Policisë _____

_____, më ____, ____, 20__.

PIKËS SË RUAJTJES NR. _____
(heqje e masës administrative plotësuese)

Më ____, ____, 20__, ora _____, drejtuesi/pronari i mjetit në ruajtje sipas procesverbalit të dorëzimit nr. _____, datë ____, ____, 20__, për shkelje të nenit _____ të Kodit Rrugor, të ndryshuar, paraqiti:

- Lejen e drejtimit nr. _____ lëshuar në _____ më _____. ____;
- Lejen e qarkullimit nr. _____ lëshuar në _____ më _____. ____ për mjetin me targë _____;
- Mandat arkëtimin nr. _____, datë ____, ____, 20__, për shlyerjen e pagesës për _____ ditë qëndrimi në shumën _____ lekë;
- Mandat arkëtimin nr. _____, datë ____, ____, 20__, për shlyerjen e pagesës së gjobës prej _____ lekë;
- Mandat arkëtimin nr. _____, datë ____, ____, 20__, për shlyerjen e pagesës së shpenzimeve të heqjes së mjetit prej _____ lekë.

Unë _____, pasi verifikova dokumentet e paraqitura si më sipër:

Vendosa:

T'i kthej/më mjetin përdoruesit/pronarit: zotit/zonjës _____

Agjenti verifikues (kodi _____)

Procesverbali mbahet në tri kopje: Originali dhe kopja e dytë i dorëzohen eprorit të drejtpërdrejtë, si pjesë përbërëse e procesverbalit të konstatimit të shkeljes me nr. serie _____ dhe kopja e tretë qëndron në pikën e ruajtjes.

REGJISTRI I PROCESVERBALEVE TË KONSTATIMIT TË SHKELJEVE NË MUNGESË

Nr.	Data	Ora	Vendi i konstatimit të shkeljes	Pajisja me sinjalistik	Lloji i shkeljes	Procesverbali i plotësuar			Agjenti verifikues	Specialisti i sallës drejtim
						Nr. i serisë	Targa e mjetit	Vlera (me shkrim)		

Model AIS

REGJISTRI I EVIDENTIMIT TË RAPORTEVE TË AKSIDENTEVE RRUGORE

Nr.	Data e regjistrimit	Numri unik	Të dhënat e raportit të aksidentit rrugor				Mjete të përfshira					Pasojat				Drejtuesi i mjetit					Oficeri që ka kryer veprimet		Vërejtje
			Nr. i aksidentit	Data e ndodhjes	Kodi i rrethit	Kodi i punonjësit të Policisë	Kamion	Autobus	Veturë	Motomjete	Këmbësorë	Vrarë	Plagë e rëndë	Plagë e lehtë	Jo plagosje	Seksi	Nr. i lejedrejtimit	Kategoria	Vlefshmëria	Data e lëshimit	Emër, mbiemër	Firma	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24

Shënim.

- Në kolonën e parë shënohet numri rendor progresiv.
- Në kolonën e dytë shënohet data e hedhjes në regjistër (p.sh. 22.12.2014).
- Në kolonën e tretë shënohet numri unik që merret nga salla e drejtimit (p.sh. TRDP121642).
- Në kolonën e katërt shënohet numri i aksidentit (p.sh. TR/01/315/12).
- Në kolonën e pestë shënohet data e ndodhjes së aksidentit.
- Në kolonën e gjashtë shënohet kodi i rrethit, që është i ndryshëm nga i komisariatit (p.sh.).
- Në kolonën e shtatë shënohet kodi i punonjësit të Policisë që plotëson raportin e aksidentit rrugor.
- Në kolonat tetë, nëntë, dhjetë e njëmbëdhjetë shënohet targa i mjetit përkatës.
- Në kolonën e dymbëdhjetë shënohet me shenjen “x” kur përfshihet këmbësor në aksident.
- Në kolonat trembëdhjetë deri gjashtëmbëdhjetë shënohen me numër pasojat përkatëse të pjesëmarrësve në aksident.
- Në kolonën e shtatëmbëdhjetë shënohet seksi i drejtuesit të mjetit.
- Në kolonën e tetëmbëdhjetë shënohet numri i lejedrejtimit.
- Në kolonën e nëntëmbëdhjetë shënohet kategoria e lejedrejtimit.
- Në kolonën e njëzet shënohet afati i vlefshmërisë së lejedrejtimit.
- Në kolonën e njëzetnjë shënohet data e lëshimit të lejedrejtimit.
- Në kolonën e njëzetedy shënohet emri, mbiemri i punonjësit të Policisë Rrugore që ka kryer veprimet e para në vendngjarje.
- Në kolonën e njëzetetë nënshkruhet nga punonjësi i Policisë Rrugore që ka kryer veprimet e para në vendngjarje.

REGJISTRI I LEJEDREJTIMIEVE TË PEZULLUARA

Nr.	Emri, atësia, mbiemri	Nr. i serisë	Masa administrative plotësuese	Afati		Nr. i vendimit të OASH-së	Vërejtje
				fillon	mbaron		
1	2	3	4	5	6	7	8

Shënim.

Në kolonën 1 shënohet numri rendor konsektiv i lejedrejtimit të pezulluar.

Në kolonën 2 shënohet emri, atësia dhe mbiemri i shkelësit, të cilit i është pezulluar lejedrejtimi.

Në kolonën 3 shënohet numri i serisë së lejedrejtimit të pezulluar.

Në kolonën 4 shënohet masa administrative plotësuese që është vendosur për shkelësin.

Në kolonën 5 shënohet afati i fillimit të masës administrative plotësuese.

Në kolonën 6 shënohet afati i mbarimit të masës administrative plotësuese.

Në kolonën 7 shënohet numri i vendimit të Organit Administrativ Shtetëror.

Në kolonën 8 shënohet vërejtje që mund të ketë për këtë regjistrim.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
Drejtoria e Policisë së Qarkut
Organi Administrativ Shtetëror

Nr. _____ prot. ____ më ____ . ____ .2012

Lënda: Njoftim për detyrim paraqitje

Drejtuar: z/ znj _____
(adresa e plotë)

Në zbatim të ligjit nr. 8485 datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, kreu III nenet 56-60; ligjit nr. 8378 datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, neni 199;

Ju njoftojmë se:

Organi Administrativ Shtetëror shqyrtoi procesverbalin e konstatimit të shkeljes nr. _____ datë _____, të mbajtur në mungesën tuaj, në zbatim të nenit 178 pika 8 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, sepse nuk jeni paraqitur në zbatim të ligjit, sipas afatit të përcaktuar në procesverbalin e konstatimit shkeljes nr. _____ datë _____ dhe firmosur nga ana juaj.

Organi Administrativ Shtetëror, bazuar në ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” neni 178 pika 8, ka marrë vendimin nr. _____ datë _____ bashkëngjitur këtij njoftimi.

Pas marrjes së këtij njoftimi, jeni të detyruar të paraqiteni brenda 48-orësh pranë zyrave të OASH-së në Drejtorinë e Policisë së Qarkut _____ për të dhënë informacionin e duhur apo për të paraqitur dokumentacionin e munguar e për të cilin është aplikuar masa plotësuese e “ndalimit administrativ” të mjetit tip _____ targë _____, i cili ndodhet në pikën e ruajtjes _____, dorëzuar me procesverbalin nr. _____ datë _____, _____, 20 _____ dhe të nënshkruar po nga ana juaj.

Mosrespektimi i detyrimit për paraqitje, në kushtet kur kanë përfunduar afatet e ruajtjes së mjetit në këtë pikë ruajtje, **do të sjellë si pasojë konfiskimin** (shkatërrim ose shitje) **menjëherë të mjetit.**

Organi Administrativ Shtetëror
Kryetari

emër, mbiemër, firmë

Mora njoftimin sot në datën ____ . ____ 20 __, unë përdoruesi/pronari i mjetit:

(emër, mbiemër, firmë)

Personi që dorëzoi njoftimin: _____
(emër, mbiemër, firmë)



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E BRENDSHME
Drejtoria e Pergjithshme e Policise se Shtetit
Drejtoria e Policise Qarkut
Organi Administrativ Shteteror

Lidhja 14/1

Nr _____ Prot. _____ me _____, 2012

Lënda: Njoftim për detyrim paraqitje.

Drejtuar: Z/ Znj _____
(Adresa e plotë)

Në zbatim të ligjit Nr 8485 datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative" Kreu III Nenet 56 - 60; ligjit Nr 8378 datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Nenet 211 dhe 199;

Ju njoftojmë se:

Policia Rrugore, në zbatim të nenit 157 pika 1 të ligjit nr 8378 date 22.07.1998, (Kodi Rrugor) i ndryshuar, në mungesën tuaj, me procesverbalin e konstatimit të shkeljes nr. _____ dt _____, (kopje bashkëlidhur) ka marre masën administrative plotësuese të heqjes së mjetit tip _____ targe _____ nga vendi _____ dhe transportin e saj ne piken e ruajtjes se mjeteve te ndaluara nga Policia e Shtetit ne _____ sepse ishte e parkuar ne kundërshtim me nenin _____ pika _____ të ligjit nr 8378 datë 22.07.1998, (Kodi Rrugor), i ndryshuar.

Pas marrjes se këtij njoftimi jeni te detyruar te paraqiteni brenda 5 ditësh, pranë zyrave te _____ për kryerjen e pagesës të shpenzimeve të ndërhyrjes, heqjes e ruajtjes dhe tërheqjen e mjetit.

Mosrespektimi i detyrimit për paraqitje, ne zbatim te pikës 4 te nenit 211 të ligjit Nr 8378 date 22.07.1998, (Kodi Rrugor), **do të sjellë si pasojë tjetërsimin** (shkatërrim ose shitje) menjëherë të mjetit .

Shefi i Komisarariatit te _____

Emër Mbiemër Firma

Mora njoftimin sot me date _____ 20____, unë përdoruesi/pronari i mjetit:

(Emër, Mbiemër, Firma)

Personi që dorëzoi njoftimin: _____
(Emër, Mbiemër, Firmë)



Model 1 / AR, Nr.7

PASQYRA E AKSIDENTEVE RRUGORE SIPAS LLOJIT TE RRUGËS,VENDIT, KUSHTEVE E SHKAQEVE

MUAJI _____ VITI _____, KOMISARIATI I POLICISË _____ / REPUBLIKA

Nr.	Përshkrimi	Aksidente	Mjete përfshirë		Vrarë		Plagosur rëndë		Plagosur lehtë	
			Të Siguruar	Të Pasiguruar	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra
a	b	c	e	f	g	h	i	j	k	l
	TOTALI AKSIDENTE									
1	Dita e Ndodhjes së Aksidentit									
	E Hënë									
	E Martë									
	E Mërkurë									
	E Enjte									
	E Premte									
	E Shtunë									
	E Dielë									
2	Ora e Ndodhjes së Aksidentit									
	00.00 - 06.00									
	06.00 - 08.00									
	08.00 - 12.00									
	12.00 - 14.00									
	14.00 - 17.00									
	17.00 - 19.00									
	19.00 - 24.00									
3	Gjeometria e Rrugës									
	Rrugë e drejtë									
	C - Kthesë									
	O - Rreth									
	(T, Y, +) - Kryqëzim									
	Urë									
	Tunel									
4	Klasifikimi i Rrugës									
	Autostradë									
	Rrugë interurbane kryesore									
	Rrugë interurbane dytësore									
	Rrugë urbane kryesore									
	Rrugë urbane dytësore									
	Rrugë lokale									
	Rrugë të tjera,parqe,rep.usht,porte,aerop.									
5	Kushtet e Rrugës									
	E mirë / premtuese									
	Me gropa									
	Me valëzime									
	E rrëshqitshme									
	Me pluhur									
6	Moti									
	Mot i thatë									
	Me shi / i lagësht									
	Me borë / ngrica									
	Me mjegull									

[illegible]

SPECIALIST I/E

SHEFI I SEKSIONIT / SEKTORIT



PASQYRA E AKSIDENTEVE RRUGORE SIPAS STRUKTURAVE TË POLICISË RRUGORE.

MUaji _____ VITI _____, REPUBLIKA

Nr.	STRUKTURA	Aksidente	Mjete përfshirë		Vrarë		Plagosur rëndë		Plagosur lehtë	
			Të Siguruar	Të Pasiguruar	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra
a	b		d	e	ë	f	g	h	i	j
	TOTALI AKSIDENTE									
1	KOM.POL.TRAF. BERAT									
	BERAT									
	KUÇOVË									
	SKRAPAR									
2	KOM.POL.TRAF. DIBËR									
	BULQIZË									
	DIBËR									
	MAT									
3	KOM.POL.TRAF. DURRËS									
	DURRËS									
	KRUJË									
	SHIJAK									
4	KOM.POL.TRAF. ELBASAN									
	ELBASAN									
	GRAMSH									
	LIBRAZHD									
	PEQIN									
5	KOM.POL.TRAF. FIER									
	FIER									
	LUSHNJE									
	MALLAKASTËR									
6	KOM.POL.TRAF. GJIROKASTËR									
	GJIROKASTËR									
	PËRMET									
	TEPELENË									
7	KOM.POL.TRAF. KORÇË									
	DEVOLL									
	ERSEKË									
	KORÇË									
	POGRADEC									
8	KOM.POL.TRAF. KUKËS									
	HAS									
	KUKËS									
	TROPOJË									
9	KOM.POL.TRAF. LEZHË									
	LAÇ									
	LEZHË									
	MIRDITË									
10	KOM.POL.TRAF. SHKODËR									
	M.MADHE									
	PUKË									
	SHKODËR									

Nr.	STRUKTURA	Aksidente	Mjete përfshirë		Vrarë		Plagosur rëndë		Plagosur lehtë	
			Të Siguruar	Të Pasiguruar	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra
a	b		d	e	ë	f	g	h	i	j
	Aksidente Gjithsej									
11	KOM. RAJ.POL.RRUG. TIRANË									
	TIRANE									
	KAVAJË									
12	KOM.POL.TRAF. VLORE									
	DELVINË									
	SARANDË									
	VLORE									
13	KOM. M.T.I. LEZHE									
	MIRDITE									
	KUKËS									
	LAÇ									
	LEZHË									
	SHKODER									
	KRUJE									
	MALESI E MADHE									
14	KOM. M.T.I. LUSHNJE									
	FIER									
	LUSHNJE									
	MALLAKASTËR									
	DURRES									
	KAVAJE									
	VLORE									
15	KOM. M.T.I. ELBASAN									
	ELBASAN									
	POGRADEC									
	LIBRAZHD									
	PEQIN									

SPECIALIST I/E

SHEFI I SEKTORIT STATISTIKËS & PERPUNIMIT DOKUMENTEVI



Model 2/ AR, Nr.8/1

PASQYRA E AKSIDENTEVE RRUGORE SIPAS NDARJES TERRITORIALE TË KOMISARIATEVE TE POLICISE

MUAJI _____ VITI _____, KOMISARIATI I POLICISË _____

Nr.	AKSIDENTET SIPAS NDARJES ADMINISTRATIVE	Aksidente	Mjete përfshirë		Vrarë		Plagosur rëndë		Plagosur lehtë	
			Të Siguruar	Të Pasiguruar	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra
a	b		d	e	ë	f	g	h	i	j
1	Rrethi									
2	Rrethi									
3	Rrethi									
4	Rrethi									
5										
6										
7										
...										
TOTALI KOMISARIATI										

SPECIALIST I/E

SHEFI I SEKSIONIT

Model 1 / MA, Nr.9

PASQYRA E MASAVE ADMINISTRATIVE SIPAS KUNDËRVAJTEVE

MUAJI _____ VITI _____, KOMISARIATI I POLICISË _____ / REPUBLIKA

Nr.	LLOJI I KUNDËRVAJTJES	MASAT ADMINISTRATIVE								
		Gjoha të Vendosura		Gjoha të Vjelura				Leje Drejtimi Pezulluar	Mjete të Ndaluar	
		TOTALI		TOTALI		Nga Organi Administ.			TOTALI	Sekuestro
Sasia	Vlera (lekë)	Sasia	Vlera (lekë)	Sasia	Vlera (lekë)					
1	Drejtimit mjeti pa leje drejtimi									
2	Kufizim qarkullimi në autostrada/inter.kryesore									
3	Mosmbajtje krahu (Poz.qarkullim ne karrexhatë)									
4	Largësia e sigurisë ndërmjet mjeteve									
5	Mosrespektim i normave të shpejtësisë									
6	Mosrespektim i sinjalizimeve rrugore									
7	Parakalime të gabuara									
8	Përdorim i ap.radiotel. gjatë drejtimit të mjetit									
9	Përdorim i pijeve alkoolike, lëndëve droguese etj									
10	Përdorim jo i drejte i dritave									
11	Qarkullim me ngarkesa apo kushte jonormale									
12	Qarkullim me të meta teknike									
13	Qarkullim pa dokumentacion të nevojshëm									
14	Qarkullim pa kaskë mbrojtëse									
15	Qarkullim pa regjistruar të shpejtësisë dhe kohës									
16	Qarkullim pa rrip sigurimi/sisteme fiksime									
17	Qarkullim pa sigurim të detyrueshëm									
18	Qarkullim pa targa regjistrimi/shenja identifikimi									
19	Qëndrime/Pushime të ndaluara									
20	Shkelje të legjislacionit nga biçikletat dhe karrocet									
21	Shkelje të legjislacionit nga këmbësoret									
22	Shkelje të tjera të rregullave të qarkullimit									
23	Largim nga vendi i aksidentit									
TOTALI										

SPECIALIST I/E

SHEFI I SEKSIONIT / SEKTORIT



PASQYRA E MASAVE ADMINISTRATIVE SIPAS STRUKTURAVE TË POLICISE

MUAJI _____ VITI _____, REPUBLIKA

Nr.	KOMISARIATI I POLICISË	MASAT ADMINISTRATIVE								
		Gjoha të Vendosura		Gjoha të Vjelura				Leje Drejtimi Pezulluar	Mjete të Ndaluara	
		TOTALI		TOTALI		Nga Organi Administ.			TOTALI	Sekuestro
Sasia	Vlera (lekë)	Sasia	Vlera (lekë)	Sasia	Vlera (lekë)					
1	Komisariati i Policise Trafikut BERAT									
2	Komisariati i Policise Trafikut DIBËR									
3	Komisariati i Policise Trafikut DURRËS									
4	Komisariati i Policise Trafikut ELBASAN									
5	Komisariati i Policise Trafikut FIER									
6	Komisariati i Policise Trafikut GJIROKASTËR									
7	Komisariati i Policise Trafikut KORÇË									
8	Komisariati i Policise Trafikut KUKËS									
9	Komisariati i Policise Trafikut LEZHË									
10	Komisariati i Policise Trafikut SHKODËR									
11	Komisariati Rajonal i Policise Rrugore TIRANË									
12	Komisariati i Policise Trafikut VLORË									
13	Komisariati M.T.I. LEZHE									
14	Komisariati M.T.I. LUSHNJE									
15	Komisariati M.T.I. ELBASAN									
	TOTALI NJËSITË									

SPECIALIST I/E

SHEFI I SEKTORIT STATISTIKËS & PERPUNIMIT DOKUMENTEVE

VENDIM
Nr. 299/1, datë 30.11.2012

**PËR PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE PËR GJYQTARË NË
GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË DHE TË APELIT**

KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË

Në mbështetje të nenit 5 pika 4 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, si dhe ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, në mbledhjen e tij të datës 30.11.2012,

VENDOSI:

KREU I
RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky vendim përcakton rregulla të detajuara për organizimin e procesit të përzgjedhjes së kandidatëve për gjyqtarë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë dhe të Apelit.

Neni 2
Parimet

Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve për gjyqtarë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë dhe të Apelit, bazohet në parimet e ligjshmërisë, të transparencës dhe të meritokracisë.

Neni 3
Subjektet

1. Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD) është organi përgjegjës për procesin përzgjedhës të kandidatëve për gjyqtarë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë dhe të Apelit.

2. KLD-ja bashkëpunon me Shkollën e Magjistraturës, Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës dhe me institucionet ndërkombëtare që operojnë në fushën e drejtësisë dhe të forcimit të shtetit të së drejtës, për përzgjedhjen e kandidatëve për gjyqtarë.

Neni 4
Procesi përzgjedhës

Procesi përzgjedhës i gjyqtarëve organizohet në dy faza:

1. Përgatitja dhe zhvillimi i testimit seleksionues;
2. Përzgjedhja e kandidatëve bazuar në rezultatet e testimit.



KREU II PËRGATITJA DHE ZHVILLIMI I TESTIMIT SELEKSIONUES

Neni 5 Paraqitja e kërkesave

1. Kandidati i interesuar për t'u emëruar gjyqtar i gjykatës administrative të shkallës së parë dhe/ose gjyqtar i gjykatës së apelit administrativ, paraqet kërkesën e vet me shkrim pranë KLD-së, brenda afatit të caktuar në shpalljen publike të vendeve vakante.

2. Komisioni i Shqyrtimit të Kandidaturave, pasi shqyrton të gjitha kërkesat brenda 5 ditëve, verifikon përmbushjen e kriterëve të mëposhtme ligjore:

a) Për kandidatët në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë:

- i) të jetë në detyrën e gjyqtarit, me përvojë prej jo më pak se 5 vjet;
- ii) të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

b) Për kandidatët në Gjykatën Administrative të Apelit:

- i) të jetë në detyrën e gjyqtarit, me përvojë prej jo më pak se 9 vjet;
- ii) të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

3. Komisioni zbaton për aq sa është e mundur dhe për aq sa nuk bie ndesh me këtë vendim, rregullat e vendimit nr. 274/2, datë 16.2.2011 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Shqyrtimit të kandidatëve për gjyqtarë", i ndryshuar.

4. Komisioni i Shqyrtimit të Kandidaturave përgatit listën përfundimtare për secilën gjykatë dhe urdhëron që ajo të njoftohet publikisht.

5. Kandidatët që kanë paraqitur kërkesë dhe që janë skualifikuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Kandidaturave, mund të ankohen brenda dy ditëve nga njoftimi publik. Ankimi shqyrtohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

6. Lista përfundimtare e kandidatëve, menjëherë pas përfundimit të afatit të ankimit, nëse nuk ka asnjë ankesë ose pas vendimit të KLD-së mbi shqyrtimin e ankesave të paraqitura, i përcillet Shkollës së Magjistraturës nga Zëvendëskryetari i KLD-së.

Neni 6 Ngritja e Komisionit të Fondit të Pyetjeve

1. KLD-ja, në çdo rast që zhvillohet procesi përzgjedhës, me vendim ngre Komisionin e Fondit të Pyetjeve të testimit seleksionues, i cili përbëhet nga tre anëtarë:

- a) 1 anëtar i KLD-së, njëherazi kryetar i Komisionit;
- b) 1 anëtar i zgjedhur nga Shkolla e Magjistraturës;
- c) 1 anëtar i zgjedhur nga Fakulteti i Drejtësisë në Universitetin e Tiranës.

2. Çdo anëtar i Komisionit plotëson dhe nënshkruan deklaratën që nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit, në kohën e ushtrimit të kësaj detyre. Deklarata hartohet sipas modelit standard në aneksin 1 dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.

3. Shkolla e Magjistraturës dhe Fakulteti i Drejtësisë në Universitetin e Tiranës dërgojnë emrin e kandidatit përkatës pranë KLD-së, brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit të KLD-së. Ata përfshijnë ekspertë me njohuri të spikatura të së drejtës kushtetuese, administrative, civile, procedurale civile, financiare, të të drejtave të njeriut dhe/ose shkrimit e arsytimit ligjor.

4. Komisioni i Fondit të Pyetjeve bashkëpunon me Shkollën e Magjistraturës dhe Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, për përgatitjen e pyetjeve në përputhje me programin e përcaktuar në ligj.

5. Komisioni, në bashkëpunim me ekspertë të Shkollës së Magjistraturës dhe të Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, krijon një fond pyetjesh me të paktën 10 teza prej 100 pikësh

për testimin e parë. Ky fond pyetjesh përditësohet vijimësisht me zhvillimin e testeve të radhës për përzgjedhjen e gjyqtarëve në gjykatat administrative. Komisioni, nën kujdesin e kryetarit, harton dhe nënshkruan procesverbalin për përfundimin e krijimit të fondit të pyetjeve, në përputhje me rregullat e këtij vendimi.

6. Kryetari i Komisionit raporton me shkrim në KLD, për mbarëvajtjen dhe përfundimin e procesit të krijimit apo të përditësimit të fondit të pyetjeve të testimit seleksionues, të paktën 1 javë përpara datës së caktuar për testim nga KLD-ja. Ai i bashkëlidh raportit edhe procesverbalin e hartuar sipas pikës 5 të këtij neni.

7. Anëtarët e Komisionit të Krijimit të Fondit të Pyetjeve janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e pyetjeve dhe përgjigjeve.

Neni 7

Përmbajtja e tezës

1. Çdo tezë e hartuar nga Komisioni duhet të jetë e organizuar me pyetje në formë alternativash dhe kazuse konkrete praktike, përgjigjet e të cilave jepen në mënyrë skematike.

2. Teza duhet të përfshijë njohuri të së drejtës kushtetuese, administrative, civile, procedurale civile, financiare, të të drejtave të njeriut, shkrimit e arsyetimit ligjor, me një total prej 100 pikësh.

3. Çdo tezë përmban:

a) 1 kasus praktik nga fusha e së drejtës administrative, të vlefshëm me 10 % të totalit të pikëve. Përmbajtja e kazusit praktik zërthehet me pyetje, që kërkojnë përgjigje në formë alternativash;

b) 50 % e pyetjeve nga e drejta administrative në formë alternativash;

c) 10 % e pyetjeve nga e drejta kushtetuese;

ç) 10 % e pyetjeve nga e drejta procedurale civile;

d) 5 % e pyetjeve nga e drejta civile;

dh) 5 % e pyetjeve nga e drejta financiare;

e) 5 % e pyetjeve nga të drejtat e njeriut; dhe

ë) 5 % e pyetjeve nga shkrimi e arsyetimi ligjor.

Çdo pyetje duhet të ketë vetëm një alternativë të saktë.

4. Çdo tezë shoqërohet edhe me çelësin e përgjigjeve, që tregon domosdoshmërisht edhe referencën ligjore që zgjidh pyetjen, pa asnjë dyshim.

5. Me përfundimin e procesit të hartimit për herë të parë apo të përditësimit të fondit në vijim, Komisioni e depoziton fondin e pyetjeve të sekretuara në zarfe të vulosura me vulë të Shkollës së Magjistraturës në KLD, ku ruhen nga Zëvendëskryetari i KLD-së. Fondi i pyetjeve është në pronësi të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Neni 8

Data e testimit seleksionues

1. KLD-ja cakton me vendim datat e testeve, sipas nevojave dhe pas shpalljes së vendeve vakante.

2. Në caktimin e datës së testimit me shkrim, KLD-ja kujdeset që testimi të zhvillohet në të njëjtën ditë për gjyqtarët e gjykatave administrative të shkallës së parë dhe në një ditë tjetër për gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Apelit.



Neni 9

Ngritja e Komisionit Administrues të Testimit

1. KLD-ja, me vendim ngre një komision që administron testimin kualifikues. Komisioni Administrues i Testimit përbëhet nga 5 anëtarë të përzgjedhur si më poshtë:

a) një përfaqësues i zgjedhur me shumicë votash nga KLD-ja brenda ose jashtë radhëve të tij, njëherazi kryetar i Komisionit;

b) një përfaqësues i zgjedhur nga Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës;

c) një anëtar i Gjykatës së Lartë i zgjedhur nga mbledhja e përbashkët e gjyqtarëve të saj;

ç) dy përfaqësues nga institucione ndërkombëtare, që asistojnë ose bashkëpunojnë me sistemin e drejtësisë, të përzgjedhur nga Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës.

2. Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës dhe Kryetari i Gjykatës së Lartë dërgon në KLD emrat e përfaqësuesve të këtij Komisioni, jo më vonë se 1 javë nga marrja e kërkesës së KLD-së.

Çdo anëtar i Komisionit plotëson dhe nënshkruan deklaratën, që nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit në kohën e ushtrimit të kësaj detyre. Deklarata hartohet sipas modelit standard në aneksin 2 dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.

3. Komisioni ka për detyrë organizimin, ndjekjen e procedurës së testimit, vlerësimin dhe shpalljen e rezultateve të tij.

4. Komisioni, në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, trajnon kandidatët paraprakisht testimit për mënyrën e plotësimit të tezës, që korrigjohet me metodën e vlerësimit elektronik.

5. Kryetari i Komisionit raporton me shkrim në KLD për mbarëvajtjen dhe përfundimin e procesit të testimit seleksionues, jo më vonë se 1 javë nga zhvillimi i tij.

Neni 10

Zhvillimi i testimit

1. Testimi seleksionues zhvillohet me shkrim, i shoqëruar me vlerësimin elektronik të përgjigjeve alternative, në prezencë të kandidatëve me një procedurë të hapur publike.

2. Përzgjedhja e tezës së testimit nga fondi i gjitha pyetjeve të përgatitura, bëhet nga vetë kandidatët para fillimit të testimit seleksionues.

3. Testimi seleksionues kryhet kundrejt një procedure të sigurt sekretimi dhe mund të mbikëqyret nga një grup monitoruesish të pavarur, vendas dhe të huaj, nga organizata me të cilat Shkolla e Magjistraturës ka pasur dhe ka marrëdhënie bashkëpunimi.

4. Përzgjedhja e tezës së testimit nga fondi i gjitha pyetjeve të përgatitura bëhet nga vetë kandidatët para fillimit të testimit seleksionues.

5. Komisioni Administrues i Testimit, nëse konstaton shkelje të rregullave të testimit nga kandidati, ka të drejtë të vendosë edhe përjashtimin nga testimi, duke mbajtur një procesverbal ku tregohet lloji dhe rrethanat e shkeljes. Konstatimi i shkeljeve bëhet kryesisht nga Komisioni ose me njoftim nga monitoruesit e pavarur.

6. Rregullat e konkursit të pranimit në Shkollën e Magjistraturës, të miratuara nga Këshilli Drejtues i saj, zbatohen për aq sa është e mundur dhe sa nuk bien ndesh me këtë vendim.

Neni 11

Caktimi i monitoruesve

1. Zhvillimi i testimit mund të vëzhgohet nga monitorues të pavarur, të cilët nuk mund të jenë persona të përfshirë në sistemin gjyqësor shqiptar apo pedagogë të Shkollës së Magjistraturës.

Akreditimi i monitoruesve bëhet mbi bazën e të dhënave vetjake të tij. Një organizatë vendase apo ndërkombëtare nuk mund të ketë më shumë se dy-tre vëzhgues.

2. Kërkesat e monitoruesve për akreditim i paraqiten Komisionit Administrues të Testimit, jo më vonë se 5 ditë para datës së testimit. Komisioni miraton kërkesat jo më vonë se 3 ditë nga paraqitja e tyre. Ndaj refuzimit ose mosdhënies së akreditimit mund të bëhet ankim te Zëvendëskryetari, i cili vendos brenda 24 orëve.

Neni 12

Të drejtat dhe detyrat e monitoruesve

Gjatë kryerjes së detyrave të tyre, monitoruesit kanë këto të drejta dhe detyrime:

- a) të vëzhgojnë pa pengesë të gjitha aspektet e përgatitjes dhe zhvillimit të testimit;
- b) të paraqesin vërejtje me shkrim para Komisionit Administrues të Testimit për çdo lloj parregullsie që vërejnë;
- c) të shohin ose të vërejnë dokumentacionin ose materialet e testimit;
- ç) të respektojnë kërkesat e këtij vendimi dhe udhëzimet e Komisionit Administrues të Testimit për vëzhgimin e testimit;
- d) të mos dhunojnë të drejtën e kandidatit për konkurrim dhe të mos pengojnë procesin e testimit, të administrimit dhe të vlerësimit të tij.

Neni 13

Shpallja e rezultatit

1. Konsiderohen që kanë kaluar me sukses testimin seleksionues, kandidatët që marrin jo më pak se 70 për qind të totalit të pikëve.

2. Komisioni Administrues i Testimit rendit në mënyrë përfundimtare kandidatët fitues, sipas numrit të pikëve të marra dhe listën ia dërgon në tri kopje KLD-së. Në këtë renditje, Komisioni bazohet në rezultatin e vlerësimit elektronik të nxjerrë sipas metodologjisë së përcaktuar në bashkëpunim me institucionet ndërkombëtare, që operojnë në fushën e drejtësisë dhe të forcimit të shtetit të së drejtës në Shqipëri.

3. Lista nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit.

4. Në rast se numri i kandidatëve fitues, sipas këtij neni, është më i madh se numri i gjyqtarëve të emëruar, kandidatët e tjerë mbahen në një listë pritjeje, pa qenë e nevojshme kryerja e një testimi tjetër seleksionues, në rastet e krijimit të një vendi vakant.

5. Lista e pritjes vlen për një periudhë jo më të gjatë se 3-vjeçare.

Neni 14

E drejta e ankimit për vlerësimin

1. Kandidatët pjesëmarrës në testimin seleksionues mund të ankohen për masën dhe mënyrën e vlerësimit pranë Komisionit Administrues të Testimit seleksionues brenda 5 ditëve nga shpallja e rezultateve. Komisioni shqyrton edhe një herë vlerësimin e përgjigjeve dhe njofton ankuesin.

2. Në rast se Komisioni bën një vlerësim të ndryshëm nga vlerësimi i parë, njofton menjëherë me shkrim KLD-në.



KREU III PËRZGJEDHJA E KANDIDATËVE

Neni 15 **Përzgjedhja e kandidatëve**

1. KLD-ja përzgjedh kandidatët që kalojnë me sukses testimin seleksionues, duke mbajtur parasysh rezultatet e testimit seleksionues.

2. Në këtë procedurë mbahen parasysh për aq sa është e mundur dhe pa shkelur rregullat e këtij vendimi, rregullat e vendimit nr. 274/2, datë 16.2.2011 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Shqyrtimit të kandidatëve për gjyqtarë”, i ndryshuar.

KREU IV DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 16 **Efektet financiare**

Efektet financiare të këtij vendimi përballohen nga buxheti i KLD-së.

Neni 17 **Rregulla kalimtare për provimin e parë**

1. Testimi i parë seleksionues për gjyqtarë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë zhvillohet në Tiranë, 21 janar 2013.

2. Testimi i parë seleksionues për gjyqtarë në Gjykatën Administrative të Apelit zhvillohet në Tiranë, 22 janar 2013.

3. Ngarkohet Shkolla e Magjistraturës që të marrë masa për organizimin efektiv, me cilësi dhe në kohë, të testimit kualifikues të kandidatëve.

4. Ngarkohet administrata e Këshillit të Lartë të Drejtësisë për të bërë njoftim publik në faqen zyrtare të KLD-së dhe në të paktën dy gazeta kombëtare, për datën dhe vendin e zhvillimit të provimit.

Neni 18 **Hyrja në fuqi**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë

ZËVENDËSKRYETAR
Elvis Çefa

ANEKSI 1
DEKLARATË PËR MUNGESËN E KONFLIKTIT TË INTERESIT
TË ANËTARIT TË KOMISIONIT TË FONDIT TË PYETJEVE

Unë, _____, i zgjedhur anëtar i Komisionit të Fondit të Pyetjeve, në përputhje me nenin 6 të vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. 299/1, datë 30.11.2012, në zbatim të legjislacionit përkatës në fuqi, deklaroj nën përgjegjësinë time se në kohën e ushtrimit të kësaj detyre nuk gjendem në situatë konflikti interesi, si dhe autorizoj njëkohësisht verifikimin e të dhënave të mia nga organet e ngarkuara me ligj, në përputhje me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale.

Emër

Mbiemër

Nënshkrimi

ANEKSI 2
DEKLARATË PËR MUNGESËN E KONFLIKTIT TË INTERESIT
E ANËTARIT TË KOMISIONIT ADMINISTRUES TË TESTIMIT

Unë, _____, i zgjedhur anëtar i Komisionit Administrues të Testimit, në përputhje me nenin 9 të vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. 299/1, datë 30.11.2012, në zbatim të legjislacionit përkatës në fuqi, deklaroj nën përgjegjësinë time se në kohën e ushtrimit të kësaj detyre nuk gjendem në situatë konflikti interesi, si dhe autorizoj njëkohësisht verifikimin e të dhënave të mia nga organet e ngarkuara me ligj, në përputhje me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale.

Emër

Mbiemër

Nënshkrimi

VENDIM
Nr. 159, datë 21.11.2012

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “CEZ SHPËRNDARJE” PËR RINOVIM TË LICENCËS
“PËR AKTIVITETIN E FURNIZIMIT PUBLIK ME PAKICË TË ENERGJISË
ELEKTRIKE” ME NR. 68, SERIA P08FPP, TË MIRATUAR ME VENDIMET E BORDIT
TË KOMISIONERËVE NR. 9, DATË 25.1.2008 DHE NR. 58, DATË 3.6.2008**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “dh”, 9, 13, pika 1 germat “c” dhe “ç”, dhe nenit 15 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 23 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, të ndryshuar, neneve 5 pika 1 germa “e”, 13 dhe 16 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/ të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) në mbledhjen e tij të datës 21.11.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a. për rinovimin e licencës për aktivitetin e furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtoria e Licencave dhe e Monitorimit të Tregut,



VENDOSI:

1. Të pezullojë procesin e shqyrtimit të kërkesës për rinovimin e licencës në aktivitetin e furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike për shoqërinë “CEZ Shpërndarje” sh.a., deri në arritjen e një zgjidhjeje përfundimtare nga ana e grupit negociator të ngritur pranë METE-s për zgjidhjen e çështjes me CEZ A.S dhe marrjes së një vendimi përfundimtar nga ana e Bordit të Komisionerëve të ERE-së në lidhje me procesin e filluar për heqje të licencave shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM

Nr. 160, datë 26.11.2012

**MBI ANKIMIN ADMINISTRATIV TË KESH SHA DHE “CEZ SHPËRNDARJE” SHA NË
LIDHJE ME VENDIMIN NR. 134, DATË 17.9.2012 “PËR MIRATIMIN E
MARRËVESHJES SË FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE MIDIS SHOQËRISË
KESH SHA/FPSH DHE SHOQËRISË “CEZ SHPËRNDARJE” SHA/FPP PËR PERIUdhËN
1.1.2012 - 31.12.2014**

Në mbështetje të neneve 16 pika 3 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, të miratuara me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 26.11.2011, pasi u njoh me ankesën e shoqërisë KESH sh.a. dhe “CEZ Shpërndarje” sh.a., mbi vendimin nr. 134, datë 17.9.2012 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s mbi kontratën për furnizimin me energji elektrike ndërmjet shoqërisë KESH sh.a. (furnizuesi publik me shumicë) dhe shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a. (furnizuesit publik me pakicë) për periudhën 1.1.2012 deri më 31.12.2014, si dhe relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s,

VENDOSI:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë KESH sh.a. për sa i përket propozimit të parashikimit të një reference të saktë për rastet kur kjo shoqëri nuk ka bërë import. Si rrjedhojë, pika 8.3.ii e kontratës, riformulohet:

“Në rastin e importit të një sasi më të vogël se humbjet reale në rrjetin e shpërndarjes, “CEZ Shpërndarje” do të kompensojë këtë sasi të energjisë elektrike të siguruar nga KESH sh.a., deri në fund të muajit $m+2$. Në rast se kompensimi nuk kryhet brenda periudhës $m+2$, “CEZ Shpërndarje” sh.a. është i detyruar të kompensojë KESH sh.a., në muajin $m+3$, me vlerën monetare që i korrespondon kostove reale të shkaktuara dhe të identifikuara nga KESH sh.a., për sigurimin e kësaj sasi të energjisë elektrike. Në mungesë të importit të energjisë elektrike nga ana e KESH sh.a., për muajin përkatës, kompensimi do të bëhet me vlerën monetare që i korrespondon çmimit të importit vjetor të energjisë elektrike të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a.”.

2. Të rrëzojë pjesën tjetër të kërkesës së KESH sh.a., si të pabazuar në prova të reja që mund të çojnë Bordin e Komisionerëve të ERE-s në një vendim të ndryshëm nga ai i marrë në datën 17.9.2012.

3. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “CEZ Shpërndarje” për sa i përket propozimit të parashikimit të së drejtës së kësaj shoqërie që të blejë gjithë energjinë elektrike për furnizimin e konsumatorëve tariforë me çmim të rregulluar. Si rrjedhojë, pika 8.2 e kontratës riformulohet:

“Çdo sasi energjie elektrike e livruar për furnizim të konsumatorëve tariforë, më tepër nga ajo e planifikuar nga ana e palës pranuese, duhet t’i paguhet palës livruese me çmim të rregulluar”.

4. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë KESH sh.a. dhe “CEZ Shpërndarje” mbi vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

URDHËR
Nr. 4492, datë 5.11.2012

PËR DELEGIM TË DISA KOMPETENCAVE SHEFIT TË QENDRËS SË DOKTRINËS

Mbështetur në nenin 35, pika 2 të ligjit nr. 8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, urdhrin e Ministrit të Mbrojtjes nr. 339, datë 12.3.2012 “Për miratimin e rregullores së procedurave të botimeve doktrinare”, si dhe për arsye të detyrimeve që rrjedhin nga përmbushja e misionit dhe përgjegjësi të Qendrës së Doktrinës,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të Komandantit të Doktrinës dhe Stërvitjes te Shefi i Qendrës së Doktrinës, për komunikim të drejtpërdrejtë me struktura të FA-së, si dhe për firmosjen e praktikave të:

- fushës së standardizimit;
- fushës së hartimit të doktrinës dhe manualeve;
- fushës së zhvillimit të koncepteve dhe mësimave të nxjerra;
- hartimin e direktivave programore;
- lëshimin e vërtetimeve për personelin e Qendrës së Doktrinës për efekt dokumentacioni, përjashtuar atyre me efekt financiar;
- ngritjen e komisionit të veçantë për përllogaritjen e honorarëve për hartuesit e materialeve doktrinare (strategji, doktrina, manuale, rregullore, revistë, studime).

2. Përfshihet nga ky delegim autoriteti i komunikimit të drejtpërdrejtë me shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, zëvendësshefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së dhe komandantët e forcave dhe ato mbështetëse.

3. Përgjigjet për zbatimin e këtij urdhri Shefi i Qendrës së Doktrinës.



4. Ndjek zbatimin e urdhrit zv/komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes.
5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**GJENERAL BRIGADE
KOMANDANTI I KDS
Bardhyl Hoxha**

KËRKESE

Shtetasi Dritan Dervishi, i biri i Ramadanit dhe i Bukuries, me datëlindje 6.8.1990, lindur në Divjakë dhe banues në Shënepremte, Lushnjë, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, shpalljen të zhdukur dhe të vdekur të nënës së tij, shtetases Bukurie Dervishi.

**KËRKUESI
Dritan Dervishi**

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QBZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 10.12.2012
Doli nga shtypi më 11.12.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 58 lekë